

ЗНМ

Здружение на новинарите на Македонија



BALKAN CIVIL SOCIETY
DEVELOPMENT NETWORK



Sida



Analizë:

**LIRIA E MEDIAVE DHE
SIGURIA E GAZETARËVE NË RMV
PËRMES PRIZMIT TË
ZGJIDHJEVE EKZISTUESE LIGJORE
– Si të arrihen zgjidhje më të mira?**

Shkupi, 2021

ANALIZË:

**Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në RMV
përmes prizmit të zgjidhjeve ekzistuese ligjore
- SI TË ARRIHEN ZGJIDHJE MË TË MIRA?**

IMPRESUM

Titull

Analizë: Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në RMV përmes prizmit të zgjidhjeve ekzistuese ligjore – Si të arrihen zgjidhje më të mira?

Botues

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Projekt

Avancimi i dialogut midis shoqatave gazetareske dhe parlamenteve të Ballkanit Perëndimor për një sektor më të fortë të shoqërisë civile

Përktheu në shqip

Deniz Sulejman

Dizajn grafik

Grafotrejd doo Skopje

Shtyp

Grafotrejd doo Skopje

Tirazhi

25

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Mbrojtje të hapësirës civile-Qendra Rajonale për Zhvillim të Shoqërisë Qytetare”, financuar nga ana e Sida dhe zbatuar nga ana e BCSDN.

Përmbajtja e këtij dokumenti dhe informacionet e prezantuara nuk i përfaqësojnë qëndrimet e Sida dhe BCSDN. Përgjegjësia për informacionet dhe qëndrimet të shprehura në këtë dokument janë në tërësi të autorit/autorëve.

Shkupi, 2021

CONTENTS

1. Hyrje	7
2. Kodi Penal	9
2.1. Zgjidhjet ligjore joefikase dhe kufizimet institucionale	10
3. Legjislacioni mediatik – liria dhe pavarësia e mediave audiovizuale	17
3.1. Ligji për ASHMA – reklamimi shtetëror kërcënim për politikën redaktuese	18
3.2. Pavarësia e dëmtuar financiare është shkelje e lirisë së TVM-s.	20
4. Kodi Zgjedhor	22
4.1. Para publike për fushatat partiako-politike	22
4.2. Mungesa e kriterëve për internet-portalet	24
5. Ligji për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim	25
5.1. Parashikohet ulja e shumave për kompensim të dëmit	26
6. Struktura organizative e Agjencisë Informative Mediatike-AIM	29
7. Ligji për të drejta autoriale dhe të drejtat e lidhura me të	30
7.1. Mbrojtja e veprave autoriale gazetareske	31
7.2. Menaxhimi kolektiv i të drejtave autoriale	32
7.3. Nevojitet avancim të praktikës gjyqësore	34
8. Ligji për media	35
8.1. Online mediumet dhe korniza ligjore në të cilën funksionojnë.	35
9. Praktika pozitive	38
10. Përfundim	41
Literatura e përdorur	48
Ligje	51
Intervista	51

1. HYRJE

Analiza ka për qëllim të paraqes kornizën ligjore e cila tani është në fuqi dhe që ka të bëj me lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut, ndërsa ka për qëllim të identifikojë mospërputhjet ligjore dhe pengesat institucionale, por edhe praktikatat e mira, mekanizmat dhe iniciativat në lidhje me këto aspekte në sferën mediatike.

Në përgjithësi, ambienti mediatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitet e fundit është përmirësuar, edhe pse mungojnë zgjidhjet ligjore, të cilat do të kontribuojnë drejt një reforme efikase dhe avancim në sferën mediatike në afat më të gjatë. Në vitin 2021 vendi është ranguar në vendin e 90-të, në Indeksin për liri të mediave të agjencisë ndërkombëtare Reporterët pa kufij.¹

Edhe pse kjo paraqet një përparim të vogël në krahasim me vitin e kaluar, Raporti vlerëson se situata me mediat është përkeqësuar, përfaqësuesit qeveritar kanë vazhduar të kërcënojnë dhe të drejtojnë ofendime ndaj mediave, ndërsa kërcënimet në internet dhe sulmet verbale në rrjetet sociale janë në rritje,² pasi në vitin 2018 dhe 2019 u regjistruan një numër relativisht i ulët i rasteve. Raporti vëren se politika e mosndëshkimit vazhdojë të jetë praktikë edhe në vitin 2020³, ndërsa në favor të kësaj është edhe fakti se SHGM ka regjistruar vetëm një rast të kërcënimit të një gazetarit që ka vendim gjyqësor⁴.

Në vitin 2020 posaçërisht në cak ishin gazetarët, ndërsa numri më i madh i sulmeve ishin vërejtur në sferën online. Institucionet janë inerte dhe jomjaftueshëm të azhurnuara gjatë procedimit të rasteve dhe lëndëve në të cilën janë të kyçur profesionistët e mediave. Edhe përkundër ndalesës për reklamim shtetëror, parat publike ende kanë një pjesë të madhe në tregun mediatik, si nëpërmjet parave buxhetore të cilët u transferohen mediave për reklamim politik-partiak në fushatat zgjedhore, ashtu edhe nëpërmjet mjeteve që komunat i alokojnë në mediat në baza të ndryshme.

¹ Reporterët pa kufij (2020) Indeksi i lirisë së mediave <https://rsf.org/en/north-macedonia>.

² Po aty,

³ Po aty,

⁴ 360 shkallë (202) "Emil Jakimovski u dënua me 20 vite dhe mjekim të detyrueshëm në Bardovcë" 16.03.2020, <https://360stepeni.mk/emil-jakimovski-dobi-zatvor-od-20-mesetsi-i-zadolzhitelno-lekuvane-vo-bardovtsi/>.

Komuniteti i mediave në vazhdimësi paralajmëron për rrezikun e çrregullimit të pavarësisë në politikën redaktuese, lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes së gazetarëve.

Shteti ka obligim të sigurojë ambient politik, shoqëror dhe mediatik, në të cilët do të mundësohet dhe do të stimulojë media të lira, debat inkluzivë dhe pjesëmarrje në vendimmarrje. Në këtë drejtim shoqatat e gazetarëve dhe mediave theksojnë për nevojën për ndryshime ose plotësime në më tepër ligje të cilat përmbajnë rregullore që kanë të bëjnë me gazetarët dhe punëtorët mediatik, me çka do të mundësohet mbrojtja e tyre më efektive gjatë realizimit të obligimeve profesionale. Në atë mënyrë institucionet do të kenë më tepër kompetenca, me çka do të mundësohet angazhimi më i madh i tyre, azhurnim dhe efikasitet gjatë procedimit të rasteve në të cilat është kërcënuar siguria dhe gazetarëve dhe profesionistët e medias.

Në analizën do të shqyrtohen dispozitat në gjashtë ligjet që kanë të bëjnë me këto tre aspekte: 1) siguria e gazetarëve dhe profesionistët e medias; 2) liria dhe pavarësia e mediave dhe liria e shprehjes së gazetarëve; 3) dispozitat e përgjithshme në ligje që ndikojnë në punën e gazetarëve dhe profesionistëve të medias dhe funksionimin e mediave.

Do të theksohen edhe shembuj pozitiv nga praktika si drejtime për përmirësim të situatës në lidhje me këto tema që janë të rëndësishme për zhvillimin e sferës mediatike.

Gjetjet e analizës duhet të shërbejnë për avokim para atyre që sjellin vendime për avancimin e zgjidhjeve ligjore me çka do të përmirësohet siguria e gazetarëve dhe liritë e mediave. Në këtë mënyrë do të avancohej dialogu mes deputetëve, institucioneve, organizatat qytetaret dhe aktorët tjerë të rëndësishëm me qëllim përmirësimin e lirisë së mediave dhe lirisë së shprehjes. Organizatave gazetareske do tu mundësohet pjesëmarrje thelbësore në proceset vendimmarrëse dhe ndikimit mbi vendimet, në favor të mediave dhe profesionistët e medias.

Analiza përfshinë hulumtim të publikimeve, raporte të organizatave vendore mediatike dhe qytetare, organizatave ndërkombëtare si dhe të dhëna sekondare që kanë të bëjnë me temën. Për nevojën e analizës janë bërë gjashtë intervista të thelluara gjysmë të strukturuar: me

përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, me Prokurorinë Publike, me profesionistë të medias (2) dhe me ekspertë mediatik (2). Hulumtimi u realizua në periudhën mars-prill 2021.

Në fillim të analizës, do të shqyrtohen dispozitat e Kodit Penal të cilat i kufizojnë institucionet të veprojnë në detyrë zyrtare kur janë të cenuara të drejtat e gazetarëve dhe profesionistëve mediatik, ndërsa do të paraqiten edhe ndryshimet të cilat i propozon Ministria e Drejtësisë. Më pas do të analizohen Ligji për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike, Kodi Zgjedhor dhe Ligjit për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje të cilat përmbajnë zgjidhje të cilat mund të ndikojnë në pavarësinë e mediave dhe të politikës së tyre redaktuese, si dhe lirinë e shprehjes së gazetarëve. Duke pasur parasysh faktin se themeluesi i Agjencisë Informative Mediatike (MIA) është Qeveria, në analizën do të jepet një përshkrim i shkurt në aspekt të ndikimeve të mundshme të institucioneve mbi lirinë dhe pavarësinë e mediumit.

Analiza e ligjeve përfundon me Ligjin për të Drejtat Autoriale dhe të Drejtat e Lidhura me të dhe Ligji për Mediat të cilat përmbajnë dispozita që kanë të bëjnë edhe me të drejtat tjera dhe kushte për punë të gazetarëve dhe profesionistëve media dhe funksionimit të mediave.

Pas kësaj pasojnë mekanizma, iniciativa dhe praktika pozitive lidhur me sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e mediave, ndërsa në pjesën përfundimtare janë konkluzat dhe rekomandimet e analizës.

2. KODI PENAL

Komuniteti i mediave viteve të kaluara në vazhdimësi ka paralajmëruar për mospërputhjet ose zgjidhjet jo efikase në Kodin Penal të cilat i kufizojnë mundësitë për mbrojtje të gazetarëve dhe punonjësve mediatik gjatë kryerjes profesionale të obligimeve të tyre, ndërsa problem shtesë paraqet inercia dhe mos veprimi i institucioneve përgjegjëse në rastet kur janë të kërcënuara të drejtat dhe siguria e gazetarëve dhe profesionistët e mediave.

Edhe institucionet ndërkombëtare paralajmërojnë se dhuna dhe kërcënimet ndaj gazetarëve mbeten problem i madh në shtet. Departamenti Amerikan i Shtetit në vitin 2021 ka konstatuar se “kultura e mosndëshkimit është e rrënjosur dhe ende paraqet pengesë për sigurinë e gazetarëve. Numri i sulmeve fizike mbi gazetarët ka

shënuar rënie, por ekziston tendencë në rritje për dhunë online dhe keqpërdorime verbale.”⁵

Komisioni Evropian në Raportin e vitit 2020, thekson se “vendi duhet të sigurojë ndjekje të shpejtë dhe efikase të të gjitha rasteve të dhunës fizike dhe verbale mbi gazetarët nëpërmjet zbatimit të ligjit nga ana e organeve gjyqësore.”⁶

Sipas KE-së, është i nevojshëm një koordinim më i mirë ndërmjet institucioneve të ndryshme me qëllim që të veprohet më shpejt pas denoncimeve për shkelje, ndërsa politikanët dhe personat zyrtar duhet të promovojnë nivel më të lartë të tolerancës ndaj kritikave dhe të promovojnë lirinë e shprehjes.

2.1. Zgjidhjet ligjore joefikase dhe kufizimet institucionale

Në vitin 2020, SHGM ka regjistruar 14 kërcënime më serioze ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, të cilët në masë të madhe ishin drejtuar nëpërmjet rrjeteve sociale, ndërsa në dy raste bëhej fjalë për sulm fizik. Për krahasim, në vitin 2019, SHGM ka regjistruar 4, ndërsa në vitin 2018 vetëm 3 kërcënime dhe sulme fizike. Nga viti 2015 deri në vitin 2020, SHGM ka regjistruar gjithsej 75 raste të sulmeve të ndryshme mbi gazetarët ose punonjësit mediatik.

Gjatë kësaj, tetë nga sulmet në vitin 2020 ishin drejtuar kah gazetaret.⁷ Gazetaret Meri Jordanovska dhe Iskra Koroveshovska nëpërmjet rrjeteve sociale kanë qenë të kërcënuara nga një zyrtar shtetëror i cili njëkohësisht ka qenë edhe anëtar i një partie politike. Ky ishte edhe rasti i parë që kishte epilog në vitin 2020, duke patur parasysh faktin se Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Prokuroria Publike (PP) reagues në mënyrë të shpejtë dhe kërcënuesi u dënua me dënim me burg prej 20 muajve. Kjo shpejtësi e organeve hetuese është më tepër përjashtim se sa rregull. Nga 14 raste gjatë vitit 2020, PTHP ka formuar

⁵ US Department of State (2020) “2020 Country Report on Human Rights Practices: North Macedonia”, 30.03.2021, <https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/>

⁶ European Commission (2020) “North Macedonia 2020 Report”, Brussels: EC, 6.10.2020, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf

⁷ Bogdanov, K., Breshkovski, I. dhe Sekullovski, D. (2020) “Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve nëpërmjet ndryshimit të Kodit Penal”, Shkup: SHGM <https://bit.ly/3slkLHA>

shtatë lëndë në të cilat si subjekt i dëmtuar ose viktimë paraqitet gazetar i cili kryen detyrë të interesit publik, ndërsa tre ankesa dhe shkelje kanë qenë në kompetencë të MPB-së.⁸

Shoqata e gazetarëve një kohë të gjatë kanë paralajmëruar për mangësitë ligjore në Kodin Penal, si rezultat i së cilave institucionet përgjegjëse nuk mundën të veprojnë në bazë të detyrës zyrtare në veprat ku janë të shkelura të drejtat e gazetarëve dhe profesionistëve mediatik. Prokuroria Themelore dhe Prokuroria e Lartë, si dhe MPB janë kritikuar se janë inert dhe aspak nuk reagojnë pas denoncimeve të bëra nga SHGM, nga gazetarët ose në bazë të zërave.

Arsyetimi nga Prokuroria Publike për refuzimin e kallëzimeve panele nga gazetarët është se bëhet fjalë për vepër penale e cila nuk ndiqet në bazë të detyrës zyrtare, ndërsa gazetarët mund të iniciojnë padi private. Prokuroria, sipas Ligjit aktual, mund të ndjek veprues të veprave penale të cilat procedohen vetëm në bazë të detyrës zyrtare. Nga PTHP shpjegojnë se ballafaqohen me probleme objektive dhe subjektive të cilat ndikojnë në dinamikën e veprimit për të gjitha lëndët, përfshirë edhe ato ku si të dëmtuar paraqiten gazetarët.

“Që të mund prokuroria të veprojë për vepra penale, gazetarët duhet menjëherë, të denoncojnë në MPB, që të sigurohen provat nga ‘vendi i ngjarjes’ ... më pas MPB që të mund t’i qaset vërtetimit të identitetit të personit që ka bërë veprën penale ... dhe me provat e siguruar të ngrit kallëzim penal deri tek Prokuroria. Prokuroria Themelore në bazë të rregullave pozitive mund të iniciojë procedurë penale vetëm ndaj një autori të njohur për vepër penale”, thuhet në shkrimin e Prokurorit Publik – Sasho Rajçev dërguar tek SHGM.⁹

I njëjti kusht vlen edhe për vepra penale të bëra nëpërmjet rrjeteve sociale, ku, prokuroria duhet të konfirmojë identitetin e personit që posedon profilin, gjë që nuk është e thjeshtë. Shembull, kur ekziston dyshim për vepër penale të bërë nëpërmjet profilit në Fejsbuk, selia e së cilës është në Kaliforni të SHBA-së, prokuroria nëpërmjet MPB-së dërgon letër deri tek kompania në mënyre që të

⁸ PTHP (2020) “Informacion për formimin e lëndëve në të cilat si subjekt i dëmtuar ose viktimë paraqitet gazetarë”

⁹ PTHP (2021) “Dorëzimi i të dhënave në lidhje me pyetjet e dërguara deri tek PTH nga ana e SHGM-së” 05.04.2021

konfirmohet personi i cili e mban profilin, prej ku, shpesh herë nuk ka përgjigje ose jepen udhëzime që të kërkohen të dhëna nëpërmjet ndihmës juridike ndërkombëtare. Por edhe në ato raste, më shpesh nuk sigurohen të dhënat për personin që e posedon profilin ose ka përgjigje negative, thuhet në informacionin e Prokurorisë Themelore. Megjithatë SHGM thekson shembuj të hetimeve që kanë zgjatur shumë, edhe pse ka pasur mundësi që shumë lehtë të njëjtat të dëshmoen. Një shembull i tillë është edhe me ish kryetarin e SHGM-së, Naser Selmani, i cili ka marrë mesazhe kërcënuese në Fejsbuk, ndërsa kërcënuesi edhe publikisht e ka pranuar atë, por PTHP dhe MPB një vit e gjysmë nuk kanë mundur të zbardhin rastin.¹⁰

Një problem i madh për Prokurorinë paraqesin edhe veprat penale të bëra nëpërmjet mediave online, të cilat nuk kanë autor në tekstin, as redaktor të mediumit. Prokuroria drejtohet deri tek njësia për luftim të krimit kompjuterik dhe forenzikë digjitale në MPB, e cila duhet të konfirmojë ku është regjistruar mediumi, kush është pronari dhe themeluesi, kush është redaktori dhe autori i tekstit. Nëse mediumi është regjistruar jashtë shtetit atëherë kërkohet ndihmë ndërkombëtare, me ç'rast nëse gazetari nuk jep të dhënat themelore ose MPB nuk i siguron, atëherë PTHP nuk mund t'i vërtetojë faktet.

Nga Prokuroria Themelore e Shkupit kanë informuar se ata në mënyrë aktive kanë vepruar pas formimit të lëndëve në të cilat si palë e dëmtuar janë paraqitur gazetarët, ndërsa dinamika e veprimit dhe sjelljes së vendimeve është kushtëzuar edhe nga institucione tjera në shtet ose jashtë, prej ku janë kërkuar ose siguruar prova.¹¹

Në këtë kontekst theksohet se edhe përkundër rritjes së ingerencave të PTHP-së, mungon përkrahja sistematike, në kuptim të resurseve njerëzore, materiale dhe financiare.¹²

Përshtypja e profesionistëve mediatik është se gjendja është duke u përmirësuar kur bëhet fjalë për përgjigjet e kërkuara nga institucionet, por se kjo nuk mund të thuhet për përfundimin e procedurave.

¹⁰ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3a6NjOK>. fq.25

¹¹ PTHP (2021) "Dorëzim i të dhënave në lidhje me pyetjet e dërguara deri tek PTHP nga ana e SHGM", 05.04.2021.

¹² "SHGM (2020) Ndryshimet e paralajmëruara ligjore për siguri më të madhe të gazetarëve" <https://bit.ly/3timsqE>.

“Kërcënuesit në rrjetet sociale ende shumë ngadalë zbulohen, gjë që ndikon mbi ndjenjën e sigurisë në kryerjen e profesionit gazetaresk. Prokuroria shumë me ‘dembelizëm’ po i ndjek kryerësit e sulmeve mbi gazetarët. Arsyetimet për këtë kërkohen në MPB, e cila nuk i përgjigjet me kohë Prokurorisë për kërkesat për grumbullim të të dhënave. MBP, nga ana tjetër, shumë shpesh dhe në mënyrë të pabazuar pret konfirmim nga Fejsbuk për konfirmim të identitetit të kryerësit, gjë që mund të bëhet me një ekspertizë bazike të IP adresave”, komenton Vasko Magleshev, gazetarë në redaksinë e Prizma/BIRN.¹³

Për shkak pamundësisë Prokuroria të veprorë në bazë të detyrës zyrtare në rastet kur palë e dëmtuar janë gazetarët dhe profesionistët mediatik, SHGM dhe SPGPM tani më një kohë kërkojnë vendosjen e veprave penale të posaçme për pengimin dhe sulm ndaj gazetarëve përderisa janë duke i kryer detyrat gazetareske ose plotësim të dispozitave aktuale, me çka do të ishin vendosur dënime më të mëdha për kërcënuesit dhe sulumuesit. Në Kodin Penal gazetarët janë të definuar si persona të cilët kryejnë punë me interes publik (neni 122, faqja 9), por “nuk ekziston asnjë veprë penale me të cilat ata do të gëzonin mbrojtje të veçantë.¹⁴

Si rezultat i përpjekjeve të organizatave të gazetarëve, Ministria e Drejtësisë ka rekomanduar ndryshime dhe plotësime në Kodin Penal, sipas të cilave ndryshime, gazetarët dhe punonjësit tjerë mediatik, do të kyçeshin në grupin e profesioneve të cilët janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe sulmeve për shkak natyrës së punës së tyre, dhe do të rriten dënimet për shkelësit.

“Intervenimi i parë është në vet definicionin në nenin 122, në të cilin në listën e profesioneve të cilat në mënyrë profesionale kryejnë detyra me interes publik, janë të kyçur edhe gazetarët. Në më tepër nene është dhënë formë e kualifikuar e veprës, që nënkupton dënime më të rrepta”, shpjegon Nikolla Prokopenko, këshilltar shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë.¹⁵

¹³ Intervistë më Vasko Magleshev, gazetarë në redaksinë e Prizma, e bërë nëpërmjet postës elektronike 2.04.2021

¹⁴ Ivanov, Z. dhe Markovski, I. (2019) Kronikë për (pa) sigurinë e gazetarëve”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/04/web-MK-hronika-za-ne-bezbednostana-novinarite.pdf>. Fq. 37

¹⁵ Intervistë me Nikolla Prokopenko, këshilltar shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë, e realizuar më 20.03.2021, online

Propozimi parashikon sulmet mbi gazetarët dhe punonjësit mediatik të ndiqen në bazë të detyrës zyrtare, dhe jo pas padisë individuale sikurse deri tani (neni 14 nga Propozim ndryshimet që ka të bëj me nenin 144 nga Kodi Penal.¹⁶ Edhe për PTHP-në, kjo do të paraqet rrethanë lehtësuese kur bëhet fjalë për mbrojtje penalo-juridike të gazetarëve, ngase do të mund të ndiqen kryerësit në bazë të detyrës zyrtare, duke e pasur parasysh faktin se gazetarët do të kyçen si të dëmtuar të mundshëm së bashku me personat tjerë zyrtarë.¹⁷ Kjo posaçërisht është me rëndësi ngase gazetarët shumë rrallë herë vendosin të ngrenë padi gjatë ndonjë sulmi fizik ose kërcënimi për jetën e tyre, për shkak frikës të paraqiten si paditës në vend që institucioni Prokuror Publik, frika nga reperkusionet nga ana kërcënuesve dhe shkelësve me të cilët do të ballafaqohen gjatë procedurës, si dhe për shkak kostove të larta financiare gjatë procedurës.¹⁸

Forma e kualifikuar e veprave penale me rritje të gjobave do të futet në veprat penale “vrasje” (neni 123), “detyrim” (neni 139), “kërcënim të sigurisë” (neni 144), “pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare (neni 382 pika 3) të cilat kanë të bëjnë edhe me gazetarët dhe punonjësit mediatik nëse vepra është bërë ndaj tyre përdërisa në mënyrë profesionale kanë qenë duke i kryer detyrat e tyre.¹⁹

Në nenin 144 që ka të bëj me kërcënimin e sigurisë, intervenohet edhe në relacion me gjuhën e urrejtjes, që në fakt është vepër e përgjithshme dhe nuk ka të bëj vetëm me gazetarët. Ndryshimet parashikojnë, jo vetëm nëpërmjet sistemit informativ siç ishte deri tani, por nëse dikush kërcënon publikisht se do të bëj vepër penale (për të cilën është parashikuar dënim me burg prej pesë viteve ose dënim më i rëndë) kundër ndonjë personi në bazë racore, nacionale, gjinore, fetare,

¹⁶ Ministria e drejtësisë (2020) Propozim-ligji për plotësime dhe ndryshime të Kodit Penal, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=61439

¹⁷ PTHP “Dorëzim i të dhënave në bazë të pyetjeve nga SHGM”, 5.04.2121.

¹⁸ Bogdanov, K., Breshkovski, I. dhe Sekullovski, D. (2020) “Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve nëpërmjet ndryshimit të Kodit Penal”, Shkup, SHGM, <https://bit.ly/3slkLHA>. faqe. 41-42.

¹⁹ Ministria e drejtësisë (2020) Propozim-ligji për plotësime dhe ndryshime të Kodit Penal, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=61439

seksuale, religjioze ose çfarëdo baze tjetër, do të dënohen me burg prej një deri në pesë vite.²⁰

SHGM dhe SPGPM kërkuan intervenime edhe në nenin i cili ka të bëj me shpërndarjen e materialit racist dhe ksenofobik me anë të sistemit kompjuteri (394), për të cilin dënimi është prej një deri në pesë vite burg. SHGM vlerëson se PTHP, por edhe MPB, nëpërmjet ndryshimit të Ligjit për procedurë penale, duhet të kenë kompetencë të vepronë në bazë të detyrës zyrtare në rastet kur ka kërcënime eksplicite nëpërmjet rrjeteve sociale ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik përderisa në mënyrë profesionale janë duke i kryer detyrat e tyre. Raportet theksojnë se Sektori për krim kompjuterik dhe forenzikë digjitale pranë MPB-së, ka dërguar më tepër padi penale deri tek PTHP për shkak ekzistimit të dyshimeve për vepra penale të dënueshme në bazë të nenit 394 nga Kodi Penal²¹. Një pjesë e këtyre padive deri tek MPB i ka iniciuar SHGM në emër të gazetarëve të dëmtuar.²² SHGM dhe SPGPM kërkojnë vendosjen e veprave të reja penale në Kodin Penal. “Pengim të gazetarëve në kryerjen e detyrave profesionale” dhe “Sulm mbi gazetarët në kryerjen e detyrimeve profesionale lidhur me veprat penale “Vrasje e rëndë” dhe “Lëndim i rëndë trupor” që gjë në të ardhmen mund t’i pengojë autorët nga sulmet.²³

Nga Ministria e Drejtësisë thonë se neni “Përhapje të materialit racist dhe ksenofobik në bazë të sistemit kompjuterik” është “vepër e përgjithshme” dhe nuk ka të bëj vetëm me gazetarët por me të gjithë qytetarët. Nga Prokuroria theksojnë se kjo vepër penale është “e komplikuar dhe komplekse” dhe për të duhet të sigurohen prova, si konfirmimi i identitetit të autorit, më së shpeshti nga rrjetet sociale. Shpesh është e nevojshme ndihmë juridike ndërkombëtare, që është procedurë e gjatë, përgjigjet zakonisht janë negative, gjë që e pengon Prokurorinë të veprojë.

“Argumentet për përhapjen e urrejtjes duhet të jenë eksplicite, të kihet kujdes të mos shkelen përcaktimet kushtetuese për lirinë dhe

²⁰ Po aty

²¹ SHGM ka dërguar pyetje deri tek MPB por deri në momentin e publikimit të analizës nuk ka pasur përgjigje

²² Bogdanov, K., Breshkovski, I. Dhe Sekullovski, D. (2020) “Përmirësimi i sigorisë së gazetarëve nëpërmjet ndryshimit të Kodit Penal”, Shkup: SHGM <https://bit.ly/3slkLHA>. faqe 47.

²³ Po aty, faqe 48.

mendimin e shprehjes, si dhe strandardet e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, të cilat janë burim i së drejtës në RMV”, theksohet në përgjigjen e PTHP.

Nga tetori 2020 deri në mars 2021 nuk ka pasur ndonjë lëndë ku është dëmtuar ndonjë gazetarë.²⁴

Në online mediumet ka raste ku prodhohet dhe përhapet gjuha e urrejtjes,²⁵ por në Maqedoninë e Veriut nuk ekziston asnjë vendim gjyqësor për gjuhë të urrejtjes. Ekziston vetëm një lëndë gjyqësore në bazë të nenit 394 nga Kodi Penal e hapur në Gjykatën Themelore 1, për shkak shpërndarjes së materialit racist dhe ksenofobik me anë të sistemit kompjuteri, por aktvendimi kah fundi i 2020-tës nuk ishte fuqiplotë dhe lënda ishte në fazë të veprimit.²⁶

Analizat konstatojnë se në lidhjen ndërinstitucionale të PTHP-së, MPB-së dhe gjyqësorit, një nga institucionet rregullisht çalon.²⁷ Edhe pse në shënjestër të kritikave është PTHP, me refuzimin e padive të gazetarëve në lidhje me zhvillimet në Kuvend më 27 prill 2017, komuniteti mediatik vlerëson se vendimet gjyqësore e kanë kërcënuar lirin e shprehjes e kanë diskredituar profesionin gazetaresk dhe rolin e mediave në një shoqëri demokratike.²⁸

Gjatë sulmit në Kuvend më 27 prill 2017 më tepër gazetarë dhe punonjës mediatik të cilët ishin duke raportuar për seancën e kuvendit ishin të lënduar ndërsa ishin dëmtuar edhe pajisjet.²⁹

Kah fundi i vitit 2020, Gjykata Themelore Shkupi 2 e refuzoi padinë e gazetarëve Dushica Mrgja dhe Natasha Stojanovska të cilat e paditën shtetin për të drejtën e lirisë së raportimit për ngjarjet në Kuvend. Arsyetimi i Gjykatës ishte se gazetaret nuk kanë dorëzuar prova prej

²⁴ PTHP “Dorëzim i të dhënave në bazë të pyetjeve nga SHGM”, 5.04.2121.

²⁵ Nikodinoska, V. (2020) “Baza politike dhe ekonomike e modeleve mediatike dhe komunikatave që përhapin dezinformata dhe gjuhë të urrejtjes”, Shkup, IMM

²⁶ Po aty, faqe 9

²⁷ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3a6NjOK>. Fq.24.

²⁸ SHGM (2021) “Edhe një aktvendim i turpshëm për gazetarët për ngjarjet e 27 prillit”, 14.04.2021, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/2QgWaqD>

²⁹ Mërgja, D., Murtezi, E. dhe Bellovska, H. (2019) “Sulmet mbi gazetarët dhe punonjësit mediatik më 27 prill 2017”, Shkupo: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Napadi-27-april.pdf>

të cilave mund të konfirmohet se në ditën e ngjarjes kanë ndodhur protesta publike para Kuvendit, e as, u pranoi se kanë përjetuar dhimbje shpirtërore, frikë dhe traumë. Në prill 2021, i ishte refuzuar edhe gazetarit Goran Tërpenovski, me arsyetimin se “nuk ka qenë gazetarë ngase ka punuar në online mediumin Sakamdakazham (Sdk.mk), i cili sipas Ligjit për media, nuk llogaritet për medium”.

“Të gjitha shpresat për drejtësi dhe evropianizim të gjykatësve u shuan me aktvendimet që u sollën në bazë të padive të gazetarëve nga 27-prilli. Edhe përkundër raporteve ndërkombëtare, rekomandimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe vendimit se shteti duhet të paguaj për kompensim për 24 dhjetorin (E hëna e zezë), megjithatë këto aktvendimet u sollën pa i marrë parasysh rekomandimet e të drejtës evropiane”, komenton Hristina Bellovska, gazetare në Laboratorinë Raportuese Hulumtuese.³⁰

Mosndëshkimi ndaj autorëve mbetet i lartë dhe epilog gjyqësor kanë patur 5-10% nga lëndët në të cilat janë shkelur të drejtat e gazetarëve, të regjistruar nga SHGM në periudhën 2014-2019.³¹ Me politikën e mosndëshkimit e cila po theksohet si problem kronik në të gjitha raportet vendore dhe ndërkombëtare, dërgohet një lloj mesazhi për “tolerancë” institucionale për sulmet mbi gazetarët dhe punonjësit mediatik.

3. LEGJISLACIONI MEDIATIK – LIRIA DHE PAVARËSIA E MEDIAVE AUDIOVIZUELE

Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe Ligji për mediat e përbëjnë kuadrin rregullativ i cili ka të bëjë me mediat në Maqedoninë e Veriut. Pas ndryshimit të qeverisë gjatë vitit 2017, partitë politike u dakorduan për ndryshime në legjislativin për mediat, të cilat ndryshime duhej të sjellin reforma thelbësore në sferën e mediave. Kjo ishte e patjetërsueshme për shkak “dominimit politik të partisë në pushtet VMRO-DPMNE në tërë sferën mediatike” me çka edhe ishte

³⁰ Intervistë me Hristina Bellovska, gazetarë në Laboratorin Raportuese Hulumtuese, e realizuar nëpërmjet e-postës, 2.04.2021.

³¹ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3dgU4Qc>. fq.31.

mundësuar “keqpërdorim i rregullativës” nga viti 2011 deri në vitin 2016.³² Në të dyja ligjet ka nevojë për revizion të më tepër segmenteve për shkak se janë jofunksionale dhe të vjetërsuara. Kështu, në Ligji për ASHMA janë të nevojshme ndryshme në pjesën e transparencës dhe koncentrimin të mediave, shpërndarjen e resurseve ose avancimin e dispozitave për servis publik, ndërsa është e nevojshme implementimi i direktivës së reviduar për shërbime mediatike audiovizuale të BE-së.

Megjithatë sa i përket lirisë dhe pavarësisë së mediave audiovizuale, ndërsa me këtë edhe të gazetarëve dhe profesionistëve mediatik që punojnë në to, analiza e Ligjit për ASHMA do të fokusohet në disa dispozita të cilat kanë të bëjnë me ndalesën për reklamim shtetëror dhe financim të servisit publik RTVM-s.

3.1. Ligji për ASHMA – reklamimi shtetëror kërcënim për politikën redaktuese

Si rezultat i bisedimeve mes partive politike, në fund të vitit 2018 u miratuan ndryshime ligjore me të cilat do të ndryshojë mënyra e nominimit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe Këshillit të Programit të Servisit Publik të TVM-s, me qëllim që të sigurohet pavarësi më e madhe e këtyre trupave. Pavarësia e anëtarëve të Këshillit të ASHMA nga qendra të ndryshme politike dhe të biznesit, është kushti kryesor për pavarësinë e të gjithë mediave audiovizuale, ndërsa pavarësia e anëtarëve të Këshillit të TVM-s është e rëndësishme për pavarësinë e plotë të servisit publike dhe për lidhjen e tyre me qytetarinë. Por, deri në prill 2021 të dyja trupa nuk ishin konstituuar për shkak mospajtimeve partiake në Kuvend.

Një nga ndryshimet reformuese thelbësore, ishte shfuqizimi i mundësisë së reklamimit në mediat komerciale dhe në shtypin me parat nga buxheti i shtetit me Vendim të Qeverisë në vitin 2017. Deri në vitin 2016 pushteti e shfrytëzonte këtë mekanizëm për krijimin e relacioneve politiko-klialiste në relacion me mediat. Me ndryshimet ligjore të miratuara në fund të viti 2018 ishte

³² Trpevska, S dhe Micevski, I. (2015) Përse është i rëndësishëm integriteti i mediave: IMM, https://mim.org.mk/attachments/article/824/zosto_e_vazen_integritetot_na_mediumite_MK_v2.pdf. Faqe.68.

parashikuar që “organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, njësitet e bashkëqeverisjes lokale, institucionet publike si dhe personat juridik me autorizime publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore të mos mund të parashikojnë mjete për informim dhe njoftim të opinionit për shërbime të tyre ose aktivitetet nëpërmjet radiodifuzerëve privat” (neni 102 nga Ligji për ASHMAA). Edhe përkundër ndalesës, problemi me reklamimin e institucioneve dhe të ndërmarrjeve publike nga mjetet buxhetore edhe më tej po zvarritet, duke pasur parasysh faktin se edhe në vitin 2019, komunat kanë shpenzuar afërsisht 500.000 euro për qëllime të ndryshme në mediat.³³ Komuniteti mediatik paralajmëroi se mjetet publike nga komunat ose nga ndërmarrjet publike në mediat në nivel lokal, mund të ndikojnë mbi përmbajtjet mediatike dhe të prishin politikën e pavarur redaktuese.³⁴

Në fillim të vitit 2021, Qeveria paralajmëroi ndryshime në rregullativën e mediave e cila ka të bëjë me ndalesën e reklamimit nga ana e pushteti qendror dhe lokal në mediat, gjegjësisht shfuqizimin e nenit 102 nga Ligji me qëllim që tu ndihmohet mediave të cilat ishin të goditura nga kriza e shkaktuar në pandemia e Kovid-19, nëpërmjet mundësisë për “arritjen e marrëveshjeve me ndërmarrje publike, komuna në pjesën e transparencës së tyre dhe zbatimit të vendimeve ...”³⁵

Organizatrat gazetareske dhe mediatike kanë kundërshtuar këto paralajmërime ngase **“praktika me fushata të paguara publike në mediat private u tregua si jashtëzakonisht e dëmshme në të kaluarën, kur me parat e qytetarëve bëhej presion mbi mediat dhe politikën e tyre redaktuese”**.³⁶ Vlerësohet se kjo është në kundërshtim me praktikën evropiane ku reklamimi i paguar politik në televizionet dhe radiot është e ndaluar gjatë kohës së fushatës por edhe jashtë periudhave zgjedhore, ndërsa nga mediumet, përfshirë edhe servisin publik, pritet që të jenë me përgjegjësi shoqërore dhe të publikojnë pa pagesë përmbajtjet që

³³ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3a6NjOK>. Fq.10.

³⁴ Po aty

³⁵ Mitevska, M., “Të mos ndodhë përsëri rryshfet shtetëror i mediave”, Radio Evropa e Lirë, <https://bit.ly/2OKafvJ>; <https://ir.mk/kako-zaev-na-golema-vrata-protnuva-gruevistichtki-retsept-za-mediumski-potkup/>.

³⁶ SHGM, SPGM, IMM (2021) “Fushatat publike në mediat duhet të jenë pa pagesë”, 23.02.2021, Shkup, <https://bit.ly/2OPMJ0y>.

janë me interes publik.³⁷ Qëndrimi i komunitetit mediatik është se kthimi i mundësisë për reklamim shtetëror në mediat është kërcënim për pavarësinë e mediave, si dhe për tregun mediatik, në të cilin ka të ardhura të mjaftueshme nga Buxheti.³⁸

3.2. Pavarësia e dëmtuar financiare është shkelje e lirisë së TVM-s

Një pjesë e dispozitave nga Ligji ASHMA të cilat kanë të bëjnë me punën e Servisit Radiodifuziv Publik RTVM dhe cilat ndikojnë në gjendjen ekonomike të gazetarëve, në praktikë hasin në pengesa institucionale. Me ndryshimet që u bënë në Ligjin, në shtator të vitit 2017 u shfuqizua taksa radiodifuzive, ndërsa financimi i TVM-s u mundësua nëpërmjet parave nga Buxheti shtetëror.

Së pari ishte parashikuar për financimin e TVM-s, ASHMA dhe RDM të ndajnë 0,5% nga Buxheti, ndërsa me ndryshimet në dhjetor 2018, mes 0,8 dhe 1%, nga të ardhurat totale të realizuara në vitin paraardhës të vitit fiskal për të cilin përcaktohet shuma. Ndryshimet në modelin e financimit u bënë me qëllim që të sigurohet burim stabil i të ardhurave, si dhe pavarësim politik dhe ekonomik të servisit publik. Megjithatë, mjetet për informim të TVM-s, po ulen në vazhdimësi nga viti 2017 deri në vitin 2021,³⁹ ndërsa Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë nuk e respektoi obligimin për sigurimin e minimumit ligjor për financimin e Servisit Publik. Si rezultat i kësaj, servili publik ka në dispozicion më pak mjete se para miratimit të ndryshimeve ligjore, edhe pse një nga qëllimet themelore e atyre ndryshimeve ishte që të sigurohet financim i sigurt.⁴⁰ Kjo ka shkaktuar vështirësi shtesë në funksionimin e servisit publik dhe rritjen e borxheve ndaj shtetit, osaçërisht pas hapjes së pesë shërbimeve programore të reja.

“Financimi i TVM-s duhet të zgjidhet, ngase, zgjidhja e tanishme nuk siguron mjaftueshëm mjete. Duhet të sigurohet model adekuat, dhe për këtë na duhet qasje strategjike. Publikut i duhet ofruar përmbajtje

³⁷ SHGM, SPGM, IMM (2021) “Fushatat publike në mediat duhet të jenë pa pagesë”, 23.02.2021, Shkup, <https://bit.ly/2OPMJOy>.

³⁸ Po aty

³⁹ ASHMA (2020) Analiza e tregut të shërbimeve mediatike audiovizuele për vitin 2019, Shkup: ASHMA, <https://bit.ly/3aaYbev>. faqe. 10

⁴⁰ Po aty

kualitative, ndërsa këtë para së gjithash e pres nga servisi publik TVM”, thotë Dejan Georgievski, kryetar i Qendrës për Zhvillim të Mediave.⁴¹

Snezhana Tërpevska nga Instituti Resis, vlerëson se modeli i financimit të TVM-s me mjete nga Buxheti siguron vetëm “Stabilitet të dukshëm financiar dhe pavarësi”, ndërsa në realitet po del se Qeveria nuk po i paguan mjetet e parapara.

“Duhet të bëhet analizë nëse përqindja e parashikuar për financimin e TMV-s, përgjigjet me shpenzimet reale për prodhim të përmbajtjeve të shërbimeve programore të cilat ajo i emeton. Shembull, në Mal të Zi janë bërë ndryshime në ligjet, sipas të cilave nënshkruhet marrëveshje në mes RSP dhe Qeverisë, ku RSP së pari përpunon plan programor për atë se cilat shërbime do të ua ofrojë qytetarëve dhe për këtë plan organizohet debat publik. Në marrëveshjen e nënshkruar në mes RSP dhe Qeverisë theksohet ajo se çfarë servisi publik do t’i ofrojë qytetarëve dhe sa do të paguajë për këtë Qeveria. Mendoj se edhe tek ne Qeveria duhet në mënyrë të njëjtë t’i paguaj mjetet e nevojshme për funksionim të TVM-s”, thotë Tërpevska⁴²

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë ka reaguar duke thënë se me transferimin e më pak mjete nga ajo që është e parashikuar “prishet koncepti i pavarësisë financiare të RTVM-s, i cili është një nga dy parakushtet për servise publike të pavarura”. MSHIA tregon si “politika ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e punës së servisit publik nëpërmjet shkurtimit të paarsyeshëm të fondeve që janë paraparë me ligj⁴³ ka reaguar SHGM. Komuniteti mediatik në vazhdimësi përpiqet për zbatim në përpikshmëri të zgjidhjes ligjore që do të mundësojë financimi i servisit publik të bëhet ashtu si është parashikuar në Ligjin, me qëllim që të sigurohet pavarësia e saj politike dhe financiare.

Edhe Bashkimi Evropian konstaton se si rezultat i diskrecionit të qeverisë, servisit publik i transferohen më pakë mjete, kështu që pavarësia financiare dhe qëndrueshmëria mbeten çështje e hapur.⁴⁴

⁴¹ Intervistë me Dejan Georgievski, kryetar i Qendrës për Zhvillim të Mediave, e realizuar më 24.03.2021 online

⁴² Intervistë me Snezhana Trpevska, kryetare e Institutit Resis, realizuar më 23.03.2021, online

⁴³ Po aty

⁴⁴ European Commission (2020) North Macedonia 2020 Report, Brussels, 6.10.2020, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf, fq. 30.

4. KODI ZGJEDHOR

Reklamimi shtetëror dhe politik në të kaluarën kanë qenë mekanizmat kryesor të financimit të mediave. Me këtë minohej roli demokratik i mediave të cilat në vend që t'i shërbejnë interesit publik dhe qytetarëve, u vendosën në shërbim të qendrave të pushtetit. Kjo mangësi sistemore ishte notuar në raportet ndërkombëtare dhe vendore pas ndryshimeve politike në shtet në vitin 2016.

Reklamimi shtetëror ishte shfuqizuar në vitin 2017, ndërsa çështja e reklamimit politik ishte adresuar nëpërmjet më tepër intervenimeve në Kodin Zgjedhor nga viti 2016 deri në vitin 2020, por edhe në Ligjin për referendum dhe në Ligjin për ASHMA.

Fushatat partiake-politike janë një segment nga reklamimi politik, për të cilën ekziston mospajtueshmëri në definicionet dhe rregullat në rregulativën, për harmonizimin e qëndrueshëm, duhet të hapet një debat gjithëpërfshirës.⁴⁵

Një pjesë e dispozitave në Kodin Zgjedhor do të shqyrtohen nga aspekti i lirisë së mediave dhe lirisë së shprehjes së gazetarëve, për shkak mundësisë mediat të marrin para buxhetore për paraqitje mediatike të partive në fushatat parazgjedhore. Do të analizohen edhe dispozitat që kanë të bëjnë me internet-mediat, që e prekin aspektin e dispozitave tjera të përgjithshme e që ndikojnë mbi kushtet për punë të gazetarëve dhe funksionimin e mediave.

4.1. Para publike për fushatat partiako-politike

Komuniteti gazetaresk dhe i ekspertëve tani më një kohë të gjatë theksojnë se duhet të rishqyrtohet nevoja dhe kushtet me të cilat mund të zhvillohet reklamimi politik në mediat në Maqedoni.

Në lidhje me reklamimin e paguar politik në mediat e shtypura, politika mediatike evropiane ka qëndrim më liberal, ngase vlerëson se kjo duhet të jetë e lejuar në këtë sektor me kufizime të caktuara në aspekt të madhësisë dhe përmbajtjes së mesazheve. Sfera online i nënshtrohet shkallës më të vogël të rregullimit dhe zakonisht

⁴⁵ Trpevska, S. dhe Selmani, N. (2018) "Analizë komparative e reklamimit politik në mediat" <https://resis.mk/attach/komparativna-politicko-oglasuvanje.pdf>. <https://resis.mk/attach/komparativna-politicko-oglasuvanje.pdf>. fq. 38.

nuk është lëndë e legjislatives mediatike.⁴⁶ Megjithatë tek mediat radiodifuzive, politika e mediave nga aspekti i reklamimit politik dallohet tek shtete të ndryshme-masat janë më restriktive atje ku radiodifuzivi ka më tepër traditë, ndërsa tek vendet ku radiodifuzivi komercial është më dominant, reklamimi politik mund të jetë i pakufizueshëm.

Ndryshimet të cilat u bënë në vitin 2018 hapën probleme të reja lidhur me rregullat e reklamimit politik të mediave gjatë kohës së zgjedhjeve, posaçërisht për shkak mundësisë për kompensim të shpenzimeve nga Buxheti shtetëror dhe sollën konfuzione shtesë në lidhje me statusin e internet-portaleve.

Ligji mundëson nga Buxheti të ndahen mjete për plotësimin e obligimeve ligjore të radiodifuzerëve, mediave të shtypura dhe internet-portaleve në pjesën e publikimit të reklamimit të paguar politik të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore (neni 76-d). Ministria e financave më pas i kompenson shpenzimet për reklamimin politik të paguar në mediat në bazë të faturës së dorëzuar, media planin dhe raportimin për shërbimet e realizuara ndaj pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore.

Mjetet publike që derdhen në mediat në bazë të obligimit ligjore të partive për paraqitje mediatike në fushatën parazgjedhore, iniciuan reaksione dhe shqetësim tek komuniteti mediatik. **Kompensimi i shpenzimeve të mediave komerciale për reklamimin e partive, drejtpërdrejt nga Buxheti paraqet zgjidhje problematike ngase e “vë në pikëpyetje pavarësinë e politikës së tyre redaktuese”⁴⁷**

“Ekziston mundësia parti të caktuara të favorizojnë media të njëjta edhe në këtë mënyrë të ndikojnë mbi politikën e tyre redaktuese edhe në të ardhmen, dhe me këtë të vazhdojë klientelizmi mediatik në dëm të qytetarëve”, vlerëson Mlladen Çadikovski, kryetar i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë.⁴⁸

⁴⁶ Po aty, faqe 18

⁴⁷ Trpevska, S. dhe Selmani, N. (2018) “Analizë komparative e reklamimit politik në mediat” <https://resis.mk/attach/komparativna-politicko-oglasuvanje.pdf>.<https://resis.mk/attach/komparativna-politicko-oglasuvanje.pdf>. fq. 32.

⁴⁸ Selmani, N. (2020) “Tre milionë euro të reja për të paguar propagandë partiake në mediumet”, e publikuar në Opservatorin e Reformave Mediatike, 12.07.2020, https://mediaobservatorium.mk/novi-tri-milioni-evra-za-plakjanje-partiska-propaganda-vomediumite/?fbclid=IéAR2afBYlxk5c_-P6V5AebEVtqPeDKv1-9lrrl_fAdVxP

Shoqatat e gazetarëve SHGM, SPGM dhe KEMM e kanë kritikuar kërkesën për dorëzim të media planit në bazë të së cilës do të kompensohen shpenzimet, duke e vlerësuar si “ndërhyrje në politikën redaktuese dhe përmbajtjen programore të mediave gjatë fushatës parazgjedhore, ngase u imponohet skemë programore nga ana e partive politike”.⁴⁹

Përndryshe, për zgjedhjet Parlamentare në vitin 2020, partitë politike kishin në dispozicion 3.6 milionë euro për reklamim politik në mediat, për zgjedhjet Presidenciale në vitin 2019 kanë shpenzuar 3.75 milionë euro për fushatë mediatike, ndërsa për Referendumin në vitin 2018-rreth 1 milion euro për reklamim.⁵⁰

4.2. Mungesa e kriterëve për internet-portalet

Kodi Zgjedhor i përfshinë internet portalet si media ku partitë politike mund të realizojnë reklamimin e tyre mediatik (neni 75), megjithatë nuk janë parashikuar kriteret cilat prej tyre mund të paraqiten në Regjistrin e Komisionit Shtetëror për Zgjedhje. Kështu në regjistrin e KSHZ-së në zgjedhjet parlamentare u paraqitën 235, ndërsa në zgjedhjet presidenciale në vitin 2019-85 internet portale.

Analizat e mediave hulumtuese tregojnë se mosekzistimi i kriterëve mundëson në regjistrin e KSHZ-së të paraqiten edhe portale që nuk publikojnë përmbajtje politike (sport, kulturë, argëtim) online-mediame pa impresum, portale me pronësi të panjohur (disa të regjistruara në SHBA, Panama ose kopani tjera të panjohura), portale të shoqatave, agregateve të lajmeve, domen të paregjistruar dhe portale që nuk janë të sferës mediatike (agjencia për punësim ose guida turistike).⁵¹

“ ... Donë të thotë para zgjedhjeve mund të mbin portale ... me prapavijë të dyshimtë, pa i ruajtur kriteret për media profesionale dhe ata të jenë në të njëjtin nivel me redaksitë serioze të online

⁴⁹ SHGM (2018) “ndryshimet në Kodin Zgjedhor e kërcënojnë punën dhe lirinë e mediave”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/izmenite-na-izborniot-zakonik-gi-zagr/>.

⁵⁰ Observatorimediatic (2020) “Paratë publikë në mediat e vranë kritikën gazetareske”, e publikuar në Observatorin e Reformave Mediatike, 13.02.2020,

⁵¹ Apostolov, V dhe Tërповski, G. (2020) “Portalet dhe parat para zgjedhjeve: Rrëmuje para golit”, e publikuar në Prizma/BIRN, 07.03.2020 <https://prizma.mk/portalite-i-parite-za-izbori-guzhva-pred-gol/>

mediave dhe të kenë qasje deri tek këto mjetet. Kjo le hapësirë për dyshime serioze për korrupsion dhe keqpërdorim. Regjistri i online mediave profesionale mundej të jetë pika nisëse, shembull për KSHZ gjatë vendimit kujt t'i jep para, kur shteti u bë e shurdhur ndaj apeleve se i tërë koncepti është i gabueshëm”, ka theksuar Katerina Sinadinovska kryetare e Këshillit Drejtues të KEMM për Laboratorin Raportues Hulumtues.⁵²

Precizimi i dispozitave të cilat kanë të bëjnë me internet portalet është e patjetërsueshme për tu penguar keqpërdorimet që janë bërë deri tani, si shembull: paraqitja e më tepër portaleve nga një botues, ose, reklamim i partive tek ata portale që janë më të afërt. Problem shtesë është edhe fakti se KSHZ nuk disponon me kapacitetet të mjaftueshme për të bërë verifikim dhe selektim të aplikimeve për regjistrin.⁵³

Reklamimi politik në rrjetet sociale nuk është subvencionuar dhe e rregulluar në mënyrë të posaçme, edhe pse partitë politike në mënyrë ekstensive i kanë shfrytëzuar këto metoda për fushatë. Në lidhje me reklamimin në këto platforma ekziston transparencë jo e mjaftueshme e partive.⁵⁴

“Partitë janë të obliguara të publikojnë të dhëna për atë se ku janë reklamuar por nuk japin të dhëna të detajuara se sa kanë shpenzuar në rrjetet sociale. Kjo është “zona gri”, konstaton Snezhana Trpevska nga Instituti Resis.⁵⁵

5. LIGJI PËR PËRGJEGJËSI QYTETARE PËR SHPIFJE DHE OFENDIM

Miratimi i Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim (LPQSHO) në vitin 2012 nënkuptonte realizim i përpjekjeve shumëvjeçare e komunitetit gazetaresk dhe mediatik për dekriminalizim

⁵² Jovanovska, M dhe Cverkovska, S. (2020), “Para shtetërore për luftëra informacione zgjedhore”, e publikuar në IRL.mk, 23.07.2020, <https://irl.mk/drzhavni-pari-za-izborni-informatsiski-voni/>.

⁵³ OSBE/ODIHR, “Misioni special për vlerësimin e zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut-Zgjedhjet e parakohshme parlamentare”, 15 korrik 202,

⁵⁴ Po aty

⁵⁵ Intervistë me Snezhana Trpevska, kryetare e Institutit Resis, realizuar më 23.03.2021, online

të këtyre veprave dhe transferimin e tyre në të drejtën civile. Qëllimi i dekriminalizimit ishte të shmanget praktika e vetcenzurës tek gazetarët, të ulet numri i dhe madhësia e kompensimit për dëmin jomaterial dhe të shkurtohen shpenzimet gjyqësore.

Nga miratimi i Ligjit në të nuk janë bërë asnjë intervenim, ndërsa në Planin 18 të Qeverisë nga viti 2018 parashikohen ndryshime të cilat do të përshtateshin me trendet evropiane. Dispozitat e këtij Ligji në analizën shqyrtohen në aspekt të çështjes së lirisë së mediave dhe lirisë së shprehjes së gazetarëve.

5.1. Parashikohet ulja e shumave për kompensim të dëmit

Para dekriminalizimit të shpifjes dhe ofendimit, at shpesh ishin përdorur si instrumente për presion mbi gazetarët nga ana e përfaqësuesve të qendrave të ndryshme të pushtetit. Përpara miratimit të Ligjit, numri mosmarrëveshjeve në të cilat ishin të përfshirë qytetarët ishin rreth 330, ndërsa në vitet vijim ky numër në vazhdimësi shënonte rënie. Aktvendimet nuk përmbanin dënime të lartë në të holla, përpos me disa përjashtime siç ishte rasti “Mijallkov kundër Fokus”.⁵⁶ Në krahasim me periudhën para vitit 2017, shpifja dhe ofendimi gjithnjë e më pak përdoren nga ana e autoriteteve për presion mbi gazetarinë kritike. Raporti i Pribe nga shtatori 2017, për realizimin e prioriteteve reformuese, e konstaton uljen e numri të padive për shpifje dhe ofendim dhe thekson se kjo nuk është temë për shqetësim.⁵⁷

Ndër vite megjithatë kishte përjashtime, kryesisht nga funksionarë të lartë të cilët kanë paditur media për shpifje: përfaqësues të partisë politike BDI kanë paditur medime në gjuhën shqipe, ose, nga ana tjetër, kërcënimet për shpifje dhe ofendim në vitin 2019 nga ana e funksionarëve të lartë partiak dhe shtetëror të drejtuar kah gazetarët⁵⁸ që mund të cilësohen si instrumente për frikësim.⁵⁹ Sipas informacioneve të SHGM-së, deri në fund të vitit 2019 në Gjykatën Civile

⁵⁶ SHGM (2018) “Analiza: Aktvendimet për shpifje dhe ofendim të lëndëve gjyqësore me gazetarë”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/analiza-presudi-za-kleveti-i-navredi-n/>

⁵⁷ Georgievski, D. (2020) “Ofendimi dhe shpifja si pjesë e reformave në media”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Navredata-i-klevetata-1.pdf>. Fq.14

⁵⁸ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM. <https://bit.ly/3dgU4Qc>. Fq.11

⁵⁹ Po aty

në Shkup ka pasur 30 lëndë aktive për shpifje dhe ofendim në të cilat si palë paraqitet gazetar ose medium.⁶⁰

Zbatimi i Ligjit tregoi disa dobësi dhe mangësi që ishin konstatuar nëpërmjet monitorimit të SHGM-së, si dhe në dokumentet evropiane të cilat janë fokusuar në prioritetet themelore. Kështu, në katër vitet e para 2013-2016 nga zbatimi i Ligjit, analizat kanë treguar se shpenzimet për zhvillim të procedurave para gjykatës civile kanë qenë shumë të larta, çka u mundëson atyre që padisin gazetarë të kenë kërkesa të larta nga gjykata për dëmin e përjetuar, ndërsa disa gjykatës kanë treguar tendencë që të mbrojnë nderin dhe reputacionin e personave zyrtare.⁶¹

Praktika e gjykatave maqedonase në vendimmarrjen e padive për shpifje dhe ofendim është perceptuar prej kohësh si problemi më i madh me të cilin përballen gazetarët dhe organet e medias që paraqiten si të pandehur në ato akte, pikërisht në lidhje me trajtimin e privilegjuar që u kanë treguar padive të politikanëve.⁶² Por, gjatë viteve praktika gjyqësore ka shënuar avancim, përfshirë edhe vlerësimet për punën e një numri të vogël të gjykatësve të cilët ishin të trajnuar në interpretimin dhe zbatimin e Ligjit dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të drejta të njeriut.⁶³ Gjegjësisht lëndët për ofendim dhe shpifje deri në vitin 2019 i gjykonin tre gjykatës të trajnuar të cilët krijuan praktikë të mirë, por nga shtatori 2019 këto lëndë mund t'i gjykojnë të gjithë gjykatësit e Gjykatës Civile. Për këtë shkak, komuniteti gazetares ka theksuar nevojën e trajnimeve shtesë të gjykatësve për këtë temë specifike me qëllim që të vazhdojë edhe më tej praktika e krijuar gjyqësore.⁶⁴

Rekomandimet e BE-së në fushën e ofendimit dhe shpifjes, fillimisht kanë të bëjnë me uljen e numrit të rasteve për ofendim dhe shpifje që do të arrijnë deri tek gjykatat, nëpërmjet shfrytëzimit të ndërmjetësimit, përkrahje dhe promovim të shfrytëzimit të mekanizmave vetërregulluese

⁶⁰ Nebiu, B., Selmani, N., Sekullovski, D. dhe Naumovski, N. (2018) Maqedonia e Veriut-Treguesit për shkallën e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve 2017, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Pokazateli-na-stepen-na-sloboda.pdf>. fq.15

⁶¹ SHGM (2018) "Analiza: Aktvendimet për shpifje dhe ofendim të lëndëve gjyqësore me gazetarë", Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/analiza-presudi-za-kleveti-i-navredi-n/>

⁶² Georgievski, D. (2020) "Ofendimi dhe shpifja si pjesë e reformave mediatike", Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Navredata-i-klevetata-1.pdf>. Fq.31

⁶³ Po aty

⁶⁴ SHGM (2020) "Kërkesat principiele të SHGM-së për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim (LPQSHO) të SHGM-së", nëntor 2020.

për zgjidhjen e kontesteve, si dhe porosi politike deri tek funksionarët publik që të përmbahen nga paditë për ofendim dhe shpifje.

Sipas rekomandimeve të BE-së dhe të ekspertëve të huaj “ofendimi” dhe veprat lidhur me të duhet të hiqen nga LPQSHO dhe të mbesin në rrethin e Ligjit për detyrime, për shkak se kjo vepër nuk hyn në definicionin për shpifje sipas nenit 10 nga Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut.⁶⁵ Megjithatë, pas analizave të bëra komparative, kjo nuk ishte e pranueshme për sistemin tonë gjyqësore.⁶⁶

Për mospërputhjet tjera që dolën nga praktika, nevojiten ndryshime më të vogla dhe plotësime. Propozim-ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nga 2020-ta, përfshijë tre çështje kryesore:

“Ndryshimi i parë ka të bëjë me një nga qëllimet themelore të Ligjit dhe me të do të precizohet shpifja dhe ofendimi të nxirren para personave të tretë, gjegjësisht në opinion, siç është praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Parashikohet ulje të shumës për kompensim të dënimit, si dhe rregullim shtesë të përgjegjësisë për ofendim”, shpjegon Nikolla Prokopenko, këshilltar shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë.⁶⁷

Në pjesën e kompensimit të dëmit jomateriale parashikohet zvogëlim dhjetëfish të shumave. Kështu, nëse tani për dëmin e shkaktuar për ofendim ose shpifje nga ana e gazetarit është parashikuar kompensim jo më shumë se 2.000 euro, për redaktor ose person i cili e zëvendëson-kompensim jo më i madh se 10 mijë euro, ndërsa për person fizik-15 mijë euro, këto shuma në të ardhmen do të jenë 200, 1000 dhe 1.500 euro.

Në Ligin aktual është parashikuar nëse “publikimi ose transmetimi i fakteve të pavërteta është bërë nëpërmjet mjeteve të informimit, për shpifje mund të përgjigjen autori i deklaratës, redaktori ose personi i cili e zëvendëson në mjetin për informim publik dhe personi juridik” (neni 8.). Me ndryshimet, përgjegjësi do të mund të ngrejë edhe personi fizik i cili është pronar i një mjeti për informim publik. Më pas, paditësi mund

⁶⁵ Georgievski, D. (2020) “Ofendimi dhe shpifja si pjesë e reformave mediatike”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Navredata-i-klevetata-1.pdf>. fq14

⁶⁶ Intervistë me Nikolla Prokopenko, këshilltarë shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë, e realizuar më 29.03.2021 online.

⁶⁷ Po aty

të vendos kundër kujt do të ngrejë padi për vërtetimin e përgjegjësisë dhe kompensim të dëmit për shpifje.

Ajo që doli si problem nga praktika gjyqësore është përgjegjësia për shpifje, posaçërisht në rastet kur gjykatat ua mohojnë të drejtën të legjitimohen si gazetarë atyre që punojnë në mediat online. Gjykatat nuk kanë praktik të konzistente dhe të unifikuar në lidhje me online-mediat, dhe përderisa disa gjykata themelore dhe të apelit i kanë “pranuar” si gazetarë dhe media, gjykatat në Shkup i refuzonin lëndët në të cilat si palë paraqiteshin gazetarë nga online-mediat⁶⁸ Kontradiktë shtesë është ajo që në nenin 11 LNPSHO në mënyrë specifike ka të me përgjegjësinë pikërisht për “publikimin elektronik” për komente ofenduese dhe shpifëse në komentet nën tekste e publikuara online. Me propozim-ndryshimet nga viti 2020 parashikohet që të fshihet ky nen, që është në pajtueshmëri me qëndrimin e komunitetit gazetaresk.

Në vitin 2018, SHGM, ka dorëzuar garanca me shkrim deri tek Gjykata Supreme në RMV, me kërkesë që ta përputh praktikën gjyqësore. Si rezultat i kësaj në vitin 2019 katër gjykatat e apelit sollën konkluzën se mediat online të cilat paraqiten si palë para gjykatave civile në procedurat për ofendim edhe shpifje, do të trajtohen njësoj si mediat tradicionale.⁶⁹

6. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË INFORMATIVE MEDIATIKE-AIM

Agjencia Informativ Mediatike-AIM është formuar me vendim të Qeverisë në vitin 1998, ndërsa në vitin 2006 është riorganizuar si Shoqëri Aksionare Agjencia Informativ Maqedonisë-Shkup në pronësi të shtetit. Duke e patur parasysh faktin se themelues i Agjencisë Informativ Maqedonase është Qeveria, ajo është pjesë e kësaj analize nga aspekti i ndikimeve të mundshme të institucioneve mbi lirinë dhe pavarësinë e mediave që i kanë themeluar dhe mbi organet drejtuese e të cilave kanë kontroll.

Sipas Statutit të AIM, me të udhëheq Bordi Drejtues, ndërsa kryetari i Bordit Drejtues është edhe drejtor gjeneral dhe redaktor përgjegjës i

⁶⁸ Georgievski, D. (2020) “Ofendimi dhe shpifja si pjesë e reformave mediatike”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/ëp-content/uploads/2020/07/Navredata-i-klevetata-1.pdf>.

⁶⁹ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3a6NjOK>; fq.28

AIM. Atë e emëron Qeveria. Anëtarët e Bordit Drejtues i zgjedh Këshilli Mbikëqyrës. Bordi Drejtues është nën kontroll të Këshillit Mbikëqyrës dhe të Qeverisë, si dhe të Kuvendit të Shoqërisë. Pesë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës i emëron Qeveria.

AIM në periudhën e fundit është duke treguar profesionalizëm më të madh dhe paanshmëri në raportimin për dallim nga e kaluara: “Pas ndryshimit të pushtetit (në vitin 2016) u emëruar një udhëheqësi e re e cila ka punuar për të zgjeruar shërbimet e saj nëpërmjet ofertës së videos dhe fotografisë”.⁷⁰

Megjithatë edhe përkundër zhvillimit profesional të AIM, gjatë viteve në strukturën organizative dhe menaxhuese në përzgjedhjen e së cilës Qeveria ka ndikim direkt, mbetet problem shikuar në aspekt të pavarësisë së medimeve nga qendrat e fuqisë politike. Kështu, Qeveria, ka të drejtën diskrecionale në zgjedhjen dhe rizgjedhjen e drejtorit, gjegjësisht redaktorit kryesor dhe përgjegjës dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, ndërsa me këtë edhe ndikim mbi përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues. Kjo potencialisht donë të thotë se Qeveria mund të ketë ndikim edhe mbi politikën redaktuese të mediumit.

Organizatrat mediatike janë të qëndrimit se mënyra më e duhur për organizimin e AIM është nëpërmjet shembullit të servisit publik, RTVM-s, themelues dhe institucion përgjegjës para së cilës përgjigjet është Kuvendi. Në këtë drejtim janë të nevojshme ndryshime në përzgjedhjen e menaxhmentit të AIM.

7. LIGJI PËR TË DREJTA AUTORIALE DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TË

Të drejtat autoriale të gazetarëve dhe punonjësve tjerë mediatik, në vazhdimësi janë temë në fokus, për shkak shkeljes së tyre masive, posaçërisht në online sferën. Marrja e paautorizuar e teksteve, fotografive dhe përmbajtjeve tjera e zhvlerësojnë mundin e profesionistëve mediatik dhe ndikojnë mbi statusin e tyre ekonomik dhe social në shoqëri. Dispozitat nga ky Ligj shqyrtohen nga aspekti i i ndikimit që mund të kenë mbi punën e gazetarëve dhe profesionistëve mediatik dhe funksionimin e medimeve.

⁷⁰ IREX (2019) MSI 2019, <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-north-macedonia.pdf>. fq. 9

7.1. Mbrojtja e veprave autoriale gazetareske

Analizat e bëra nga ekspertët për Ligjin për të drejta autoriale dhe të drejtat e lidhura me të (LDADL)⁷¹ konstatojnë se janë të nevojshme ndryshime dhe plotësime të cilat kanë të bëjnë me mbrojtje më të madhe të veprave gazetareske, menaxhim kolektiv i të drejtave autoriale dhe të nevojës për mbrojtje nga të drejtat autoriale të platformave digjitale. Problem shtesë paraqet mungesa e praktikës gjyqësore në këtë fushë dhe shumat e larta për shpenzimet gjyqësore. Ministria e Kulturës ka paralajmëruar ndryshime në Ligjin dhe harmonizimin e sa me standardet evropiane, ndërsa propozim-teksti duhet të ndahet me të gjitha palët e prekura gjatë vitit 2021.

Në Ligjin autori është definuar si person të cilit i takon e drejta autoriale mbi veprën me vet krijimin dhe ai ka të drejtën të lejojë ose të ndalojë shfrytëzimin e veprës ose ndonjë pjesë të saj nga ana e personave tjerë (neni 26). Si vepra autoriale llogariten veprat e shkruara dhe gojore, fotografitë dhe veprat audiovizuale. Çdo prodhim mediatik nuk mund të vlerësohet si vepër autoriale, si për shembull lajmet dhe informacionet për aktualitete ditore. Për vepër autoriale mund të llogaritet vetëm informacioni në krijimin e së cilës gazetari ka kontribut intelektual, siç janë storjet hulumtuese, ose kronikat/ tekstet në të cilat autori vet ka zbuluar informacione.

Sipas opinionin të ekspertëve, Ligji aktual më tepër theks vendos në shkeljen e të drejtave morale dhe materiale të fotografive, ndërsa në lidhje me përmbajtjen të cilat i prodhojnë gazetarët rregullativa nuk është shumë e qartë.⁷² Avokatët të cilët punojnë në këtë problematik theksojnë se autorësia më lehtë dëshmohet tek fotografitë se sa tek tekstet gazetareske, sepse ata mund të jenë të ndryshuara në mënyrë drastike në krahasim me tekstin fillestar.⁷³ Pikërisht për këtë, disa nga mangësitë kyçe që duhet të adresohen në ndryshimet në Ligjin kanë të bëjnë me njohjen e teksteve autoriale gazetareske, që është me rëndësi

⁷¹ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numri 115/10, 140/10, 51/11, 147/13, 154/15 и 27/16

⁷² Pashoski, D. (2021) "Si Ligji për të drejta autoriale ndikon mbi punën e punonjësve mediatik", Shkup: SHGM, https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/Analiza_avtorski-prava_fin.pdf. Fq.4.

⁷³ SHGM (2020) "Puna e mediave profesionale nën goditje të plagjiaturës", Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3wTQVGt>

në proceset eventuale gjyqësore të cilat gazetarët mund t'i iniciojnë për mbrojtje të drejtave të tyre autoriale.⁷⁴

Ekspertët rekomandojnë ndryshime edhe në nenin nga e Ligjit i cili ka të bëj me veprën autoriale që është krijuar nga punëtori gjatë kryerjes së obligimeve të tyre ose pas udhëzimit të punëdhënësit (neni 86) sipas të cilit të drejtat materiale ekskluzivisht i takojnë punëdhënësit në periudhë prej pesë viteve nga krijimi i saj. Rekomandohet ndryshim i kësaj zgjidhje me çka do të garantohet se “të drejtat materiale të autorit për veprën që është krijuar gjatë realizimit të obligimeve të punës, do t'i takojnë ekskluzivisht autorit, përpos nëse me marrëveshjen për punësim nuk është përcaktuar ndryshe”.⁷⁵ Kjo çështje në vend u aktualizua posaçërisht në rastin e fotoreporteres Arbnora Mehmeti e cila i mbron të drejtat autoriale për një fotografi të saj që është bërë përderisa ka qenë e punësuar në një organizatë, të drejta këto, sipas saj, janë shkelur nga ana e subjekteve tjera juridike.⁷⁶

Ky vendim është prezent edhe në Ligjin kroat për të drejtat autoriale, ku autori është në fokusin e kësaj dispozite dhe i mban të drejtat autoriale mbi veprën.⁷⁷ Kjo është me rëndësi posaçërisht gjatë marrjes së përmbajtjeve të huaja të theksohet autori i veprës, me çka mbrohen të drejtat morale. Në këtë mënyrë autori mund më vonë t'i huazojë të drejtat materiale për një kompensim adekuat.⁷⁸

7.2. Menaxhimi kolektiv i të drejtave autoriale

Ekspertët e theksojnë edhe rëndësinë e dispozitave që kanë të bëjnë me menaxhimin kolektiv të drejtave autoriale dhe të drejtat që lidhen me ta

⁷⁴ Po aty

⁷⁵ Pashoski, D. (2021) “Si Ligji për të drejta autoriale ndikon mbi punën e punonjësve mediatik”, Shkup: SHGM, https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/Analiza_avtorski-prava_fin.pdf. fq.16

⁷⁶ SPGM dhe SHGM (2021) “E dënojme përjashtimin e padinjitetshëm të fotoreporteres Arbnora Mehmeti”, 05.03.2121, <https://www.radiomof.mk/ssnm-i-znm-go-osuduvame-nedostoinstvenoto-otpushtanje-na-fotoreporter-kata-arbnora-memeti/>

⁷⁷ Breshkovski, I., dhe Markovski, I. (2018) “Ndikimi i Ligjit për të drejta autoriale dhe të drejtat e lidhura me të mbi punën e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik-praktika dhe rekomandime”, Shkup, KAS dhe SHGM, www.znm.org.mk. Fq 21.

⁷⁸ Pashoski, D. (2021) “Si Ligji për të drejta autoriale ndikon mbi punën e punonjësve mediatik”, Shkup: SHGM, https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/Analiza_avtorski-prava_fin.pdf.

të gazetarëve dhe të fotoreporterëve (neni 129-134). Realizimi kolektiv i të drejtave mund të realizohen nëpërmjet organizatës për menaxhim kolektiv të drejtave, e cila sipas Ligjit duhet të jetë person fizik e theksuar nga persona fizik ose/ persona juridik, të punojë në qëllime joprofitabile, ndërsa lejen për punë e merr nga Ministria e Kulturës. Qëllimi i organizatës është që të mbron, përfaqëson dhe paraqet interesat e bartësve të drejtave në shtet dhe jashtë shtetit.

Rregullativa në këtë segment në Maqedoninë e Veriut nuk është zbatuar në mënyrë adekuate në praktik, dhe për këtë shkak Ministria e Kulturës në kompetencën e së cilës është Ligji ka paralajmëruar analizë të legjislacionit dhe praktikës në rajon dhe në vendet e BE-së në lidhje me realizimin kolektiv të drejtave autoriale dhe drejtave të lidhura me të.

Një nga mundësitë është formimi i një shoqatë joprofitabile për menaxhim me të drejtat autoriale të gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësit mediatic me leje ose miratim nga Ministria e Kulturës. Në Kroaci, për shembull nga viti 2007 funksionon Shoqëria për mbrojtje të drejtave të gazetarëve për mbrojtje kolektive të drejtave autoriale të gazetarëve e cila është organizatat qytetare joprofitabile e themeluar nga gazetarët.⁷⁹ Organizata financohet në bazë të anëtarësisimit dhe donacioneve, ndërsa anëtarët mund të jenë gazetarë-autorë të cilët shoqërohen për mbrojtje të drejtave autoriale gazetareske për realizimin e interesave të përbashkëta profesionale dhe përmirësimin e gjendjes sociale dhe materiale të gazetarëve.⁸⁰

Rregullativa duhet të harmonizohet me Direktivën Evropiane për Menaxhim Kolektiv me të Drejtën Autoriale dhe të Drejtat e Lidhura me të dhe licencim multiteritorial të veprave muzikore për shfrytëzim nëpërmjet internetit, me çka pas marrjes së paautorizuar të veprave të gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatic jashtë Maqedonisë, autori do të mund të kërkojë mbrojtje nëpërmjet organizatave për menaxhim kolektiv jashtë shtetit⁸¹. Kjo mundësi është në ligjin kroat.

⁷⁹ Breshkovski, I., dhe Markovski, I. (2018) "Ndikimi i Ligjit për të drejta autoriale dhe të drejtat e lidhura me të mbi punën e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatic-praktika dhe rekomandime", Shkup, KAS dhe SHGM, www.znm.org.mk. Fq 22-23

⁸⁰ Po aty

⁸¹ Po aty

7.3. Nevojitet avancim të praktikës gjyqësore

Ndryshimet në Ligjin duhet ta kenë parasysh edhe mjedisin e ri digital në të cilin autorët krijojnë vepra digjitale, për shkak të së cilës duhet të shqyrtohen edhe Direktiva Evropiane për të Drejta Autoriale dhe të Drejta lidhur me të, e cila ka të bëjë me shpërndarjen e përmbajtjes së mbrojtur të internet serivs-provajerëve (siç janë shembull yotube dhe vimeo). Gjatë kësaj, servis-provajderi duhet të sigurojë leje nga autori për shfrytëzimin e veprës së tij.⁸²

Online mediumet profesionale posaçërisht janë të ballafaquara me sfidat e të ashtuquajturës “copy-paste” gazetarisë ku në mënyrë të paautorizuar merren përmbajtje nga mediat e tyre. Megjithatë praktika gjyqësore në vendin tonë për këto shkelje është jashtëzakonisht e varfër, ndërsa procedurat gjyqësore mund të jenë të kushtueshme dhe shumë të gjata.⁸³ **Shpenzimet e mëdha gjyqësore para gjykatave civile, i pengojnë gazetarët dhe fotoreporterët të padisin. Për këtë shkak, ekspertët rekomandojnë uljen e shpenzimeve me qëllim që të inkurajojnë profesionistët mediatik të kërkojnë mbrojtje për të drejtat e tyre autoriale.**

Nga ana tjetër, disa aktvendimi gjyqësore lidhur me të drejtat autoriale, kanë treguar se shpenzimet e larta në praktikën gjyqësore mund të kontribuojnë në krijimin e vështirësive financiare për punë në e disa online medimeve të cilët e kanë humbur rastin. Mirëqenia ekonomike e medimeve është çështje posaçërisht e rëndësishme, për shkak tregut të marketingut të pazhvilluar në fushën online.

Duke e pasur parasysh praktikën e vogël gjyqësore, janë të nevojshme trajnime shtesë për gjykatësit nga gjykata civile dhe penale për tema specifike siç janë të drejtat autoriale.⁸⁴ Kjo është e nevojshme edhe nga aspekti i asaj që në disa procedura gjyqësore, disa gjykatës të caktuar nuk i njohin internet-portalet si media.

Ndryshe, një nga mekanizmat për zgjidhje jashtë gjykatës së rasteve ku është shkelur e drejta autoriale e gazetarëve dhe punonjësve

⁸² Pashoski, D. (2021) “Si Ligji për të drejta autoriale ndikon mbi punën e punonjësve mediatik”, Shkup: SHGM, https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/Analiza_avtorski-prava_fin.pdf. Fq.14

⁸³ Po aty

⁸⁴ Po aty fq 17

mediatik është vetërregullimi mediatik. Një grup i fotoreporterëve kanë formuar edhe online platformën (<http://kolektif.mk/>), në të cilën publikohen fotografi profesionale të cilat më pas mund të blihen nga ana e mediave. Kjo theksohet si formë e shoqërimit që më tej ka potencial të rritet në një mekanizëm i cili do t'i mbrojë të drejtat autoriale të fotoreporterëve.⁸⁵

8. LIGJI PËR MEDIA

Analiza e përfshinë edhe Ligjin për medime i shqyrtuar nga aspekti i asaj si disa ndryshime të caktuara ndikojnë mbi punën e gazetarëve dhe funksionimit të internet mediave, për të cilat në vitet e kaluara u hapën më tepër çështje gjatë ndryshimeve që u miratuan në disa ligje, si dhe gjatë trajtimit institucionale ndaj tyre në praktikën.

8.1. Online mediumet dhe korniza ligjore në të cilën funksionojnë

Online mediumet nuk janë përfshirë me rregullativën mediatike, sepse në mes opinionit gazetaresk dhe të ekspertëve është pranuar gjerësisht qëndrimi se në këtë mënyrë do të ishte kufizuar liria e shprehjes në online sferën, ndërsa kjo zgjidhje është në përputhje me praktikën evropiane. Nga ana tjetër ekziston frika nga keqpërdorimi i mundshëm i çfarëdolloj zgjidhje nga ana e institucioneve dhe qeverisë, madje kur bëhet fjalë edhe për të ashtuquajturën “rregullimi i butë: që do të mund të kufizonte lirin e shprehjes, demokracinë dhe pluralizmin mediatik.”⁸⁶

Megjithatë, vitet e kaluara mediat online në më tepër raste imponohen si çështje e hapur nëpërmjet zbatimit të tjera ligjeve, praktikës së institucioneve, ose në kontekst të rritjes së disa fenomeneve të padëshiruara, si gjuha e urrejtjes dhe dezinformatat. Kështu, me miratimin e Kodit Zgjedhor në vitin 2016 edhe “internet portaleve” u imponohej obligimi të sigurojnë mbulim fer të balancuar dhe të

⁸⁵ Breshkovski, I., dhe Markovski, I. (2018) “Ndikimi i Ligjit për të drejta autoriale dhe të drejtat e lidhura me të mbi punën e gazetarëve, fotoreporterëve dhe punonjësve mediatik-praktika dhe rekomandime”, Shkup, SHGM, www.znm.org.mk.

⁸⁶ SEMM (2017) “Self-regulation or Regulation of Internet Media in Macedonia”, Skopje: <https://semm.mk/attachments/SELF-REGULATION-OR-REGULATION-OF-INTERNET-MEDIA.pdf>. fq.8

paanshëm të zgjedhjeve⁸⁷ ndërsa me ndryshimet në vitin 2018 në pjesën e prezantimit mediatik u hap mundësia që edhe ata të paraqiten në regjistrin e mediave të Komisionit Shtetëror Zgjedhor ku partitë politike mund ta realizojnë reklamimin politik para zgjedhjeve.

Një pjesë e ekspertëve mendojnë se Ligji për media jep përgjigje të kësaj dileme duke e patur parasysh faktin që termi “medime” ka kuptim më të gjerë, pa dallim nga platforma teknike e shpërndarjes së informacioneve.⁸⁸ Ndryshe **në vitin 2014 në definicionin e mediave ishin fshirë “publikimet elektronike” pas insistimit të komunitetit gazetaresk, i cili ishte kundër rregullimit të online mediave, ngase kjo do të nënkuptonte rregullim më të madh të internet hapësirës që është në kundërshtim me standardet evropiane.**

Sipas definicionit ekzistues në Ligjin, “mediat janë mjetë për informim publik, gjegjësisht çfarëdolloj komunikimi si gazetata, revistat, programet e radiove dhe televizionit, teleteksti dhe mjete tjera për publikime ditore ose kohë pas kohe të përmbajtjeve redaktuese në formë të shkruar, zë ose fotografi, me qëllim që të plotësohen nevojat kulturore, arsimore dhe të tjera të opinionit më të gjerë.”⁸⁹

“Edhe pse ‘publikimet elektronike’ nuk janë të theksuara në mënyrë eksplicite në definicionin, ata në realitet janë të përfshirë me shprehjen ‘forma tjera për publikime ditore ose kohë pas kohe të përmbajtjeve redaktuese’ ... Në rrethimin e sotëm mediatik, kufiri mes medimeve ‘të vjetra’ dhe ‘të reja’, ‘offline’ dhe ‘online’ në mes ‘të shtypura’ dhe ‘elektronike’ po zhduken. Në këtë kontekst shumë vështirë është të përjashtohen online mediumet nga përfshirja në Ligjin për mediumet”, thotë Snezhana Trpevska nga Instituti Resis.⁹⁰

Ajo vlerëson se në një moment të duhur në të ardhmen duhet të hapet debat nga ana e ekspertëve për këtë çështje të ndjeshme, posaçërisht për faktin se online mediumet funksionojnë si subjekte në sferën mediatike, si dhe për shkak rritjes së gjuhës së urrejtjes dhe të dezinformatave tek një pjese e këtyre mediave. “Duhet me kujdes të

⁸⁷ Po aty, faqe 4

⁸⁸ Intervistë me Snezhana Trpevska nga Instituti Resis, e realizuar më 23.03.2021,

⁸⁹ Ligji për media, neni. 2, https://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Zakon_zamediumi_mkd.pdf

⁹⁰ Intervistë me Snezhana Trpevska nga Instituti Resis, e realizuar më 23.03.2021, online

shqyrtohen trendët evropiane-zgjidhjet e mundshme dhe mekanizmat që janë funksionale në shtetet tjera”, vlerëson Trpevska.

Problemët në online sferën janë evidente duke pasur parasysh trendët rritëse të gjuhës së urrejtjes, diskriminimit, shkeljes së të drejtave autoriale dhe diskualifikimeve. Në lidhje me këtë çështje, më tepër ekspertë theksojnë se dispozitat në ligjet aktuale që kanë të bëjnë me disa çështje të ndjeshme “janë po aq të vlefshme dhe të zbatueshme edhe për mediat tradicionale dhe online mediumet, që është në përputhje me standardet evropiane,”⁹¹

Analiza e Agjencisë për ASHMAA thekson se edhe pse nuk janë pjesë e rregullativës ligjore, online-mediumet megjithatë janë pjesë e kësaj normative ligjore.⁹²

“Për më tepër, objektivat e disa politikave publike në lidhje me përmbajtjen e publikuar nga media online (siç është shembull lufta kundër gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit dhe respektimit të drejtave autoriale) mund të mbrohen nëpërmjet ligjeve tjera përpos Ligjit për media, siç janë Kodi Penal, Ligji për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje, Ligji për parandalim nga diskriminimi, Ligji për të drejta autoriale [...] Shumica e problemeve të shkaktuara në mediat online mund të zgjidhen edhe me zbatimin e të drejtës së thjeshtë.”⁹³

Në analizën thuhet se nëse ekziston vullnet politik që të kyçen disa media online në rregullativën ligjore për media, atëherë duhet të merret parasysh rëndësia e atyre mediave për shoqërinë, por, posaçërisht duhet patur kujdes në dëmin që rregullativa mund të shkaktojë mbi mediat e vogla, në kuptimin e vendosjes së pragjeve minimale dhe të ngjashme.⁹⁴

Puna joprofesionale dhe joetike e disa mediave online është pjesërisht e mundësuar nga moszbatimi i ligjeve aktuale në praktikë, si dhe nga

⁹¹ Saraçini, P.,(ed). P. (ed.) et al. (2015) “Macedonia in the digital age – between the rights and responsibilities in the Internet communication”, Skopje: MIM, http://mim.org.mk/attachments/article/853/MIM_Analiza_mk.pdf.

⁹² Furnemon, Zh.F. (2018) “Korniza rregulluese për media dhe online media-rasti maqedonas”, Shkup: ASHMAA, <https://bit.ly/3tNfha7>. fq. 29.

⁹³ Po aty, faqe 34

⁹⁴ Po aty, faqe 35

inercia e institucioneve në trajtimin dhe sanksionimin e dukurive të caktuara, siç është gjuha e urrejtjes. Hulumtimet tregojnë se Maqedonia e Veriut ka mjaftueshëm ligje të cilat mund të zbatohen në internet sferën, por, ato duhet të zbatohen në mënyrë joselektive, fer dhe proporcionale ndaj të gjithë aktorëve në sferën publike.⁹⁵

Në lidhje me gjuhën e urrejtjes, ekspertët mediatik kanë theksuar se “korniza ligjore duhet të përmbajë një sërë masash të ndryshme, të cilat duhet të jenë kompatible me intensitetin e gjuhës së urrejtjes, ndërsa dënimet duhet çdoherë të zbatohen si masa e fundit në rastet më ekstreme, sepse kjo mund të krijojë “efekt të ftohjes” (chilling effect) tek mediat.⁹⁶ Ky rregull vlen edhe për mediat tradicionale dhe mediat online.

Vetërregullimi është edhe një mekanizëm në drejtim të vendosjes së rregullit në sferën online. Me iniciativë të Këshillit për Etik në Mediat dhe Shoqatës së Gazetarëve në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Maqedonisë, në vitin 2020 u formuar Regjistri i medive online profesionale, të cilat duhet t’i respektojnë kriteret obligative që të mund të jenë anëtarë në të. Deri në prill 2021, rreth 140 media online ishin pjesë e Regjistrimit.⁹⁷

9. PRAKTIKA POZITIVE

Sigurimi i kushteve ligjore, sociale dhe ekonomike për realizim të papenguar të obligimeve profesionale, si dhe garantimin e sigurisë dhe të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik varen nga vullneti dhe përpjekja e më tepër aktorëve shoqëror-politikanët, sektori qytetar dhe vet mediat. Mundësitë për komunikim të ndërsjellë dhe bashkëpunim mes institucioneve dhe sektorit qytetar janë parametra kyçe të cilat e përcaktojnë zhvillimin demokratik në sferën mediatike.

Edhe përkundër mospërputhjeve ligjore dhe mos-koordinimit të institucioneve, mund të veçohen shembuj pozitiv të bashkëpunimit multi-sektorial, rrjetëzime, koalicione dhe iniciativa të cilat kontribuojnë

⁹⁵ KEMM (2017) “Self-regulation or Regulation of Internet Media in Macedonia”, Skopje: KEMM, <https://semm.mk/attachments/SELF-REGULATION-OR-REGULATION-OF-INTERNET-MEDIA.pdf>.

⁹⁶ Intervistë me Snezhana Trpevska nga Instituti Resis, e realizuar më 23.03.2021,

⁹⁷ Promedia-Regjistri i mediave online profesionale <https://www.promedia.mk/main>.

për siguri më të madhe të profesionistëve mediatik ose drejt avancimit të lirive mediatike në vend.

Konstatimi gjeneral është se organizatat e gazetarëve dhe organizatat qytetare janë aktive dhe aktor të azhurnuar kur bëhet fjalë për mbrojtje ose reaksion në rastet kur janë të kërcënuar të drejtat dhe siguria e gazetarëve dhe profesionistëve mediatik. “Ndaj kësaj ndikon edhe ambienti shoqëror në të cilin punojnë gazetarët, si dhe vetëdija e gazetarëve për rëndësinë e kësaj çështje”, thotë Vasko Maglleshov, duke theksuar se institucionet reagojnë më shpejtë për dallim nga më herët.⁹⁸ Që nga përgatitja dhe miratimi i legjislativës për mediumet në vitin 2013, shoqatat e gazetarëve janë shumë aktiv në lotimin dhe përfaqësimin, me çka arritën që të parandalojnë disa propozime jopopullore të pushtetit, ose, të sigurojnë ndryshime. Kështu në vitin 2017 u shfuqizua reklamimi shtetëror, ndërsa u bënë ndryshime në nominimin dhe delegimin e trupave drejtues në Agjencinë për ASHMA dhe SRP dhe RTV. Të dy trupat ende nuk janë formuar për shkak mospajtimeve në Kuvend, që tregon për faktin se vullneti politik është kyç për ndryshime thelbësore dhe avancim në sferën mediatike.

Nga ana tjetër, **si rezultat i iniciativës së SHGM-së, e drejtuar tek Gjykata Supreme e RMV-së, për pajtueshmëri të praktikës gjyqësore, në vitin 2019, katër gjykata të apelit sollën konkluz se njësoj do t'i trajtojnë mediat online me mediat tradicionale në procedurat për ofendime dhe shpifje.** Nëpërmjet fushatës së Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik për ndalimin për marrjen e fotografive ose teksteve autoriale pa lejen e autorit, u ishte ofruar ndihmë juridike një numër të madh të autorëve të dëmtuar veprat e të cilëve u janë marrë pa leje.⁹⁹ Programi për ndihmë juridike pa pagesë për gazetarët dhe mediumet të cilën e udhëhiqte Qendra për Zhvillim të Mediave ofronte mbrojtje në gjykatë në raste të ofendimit dhe shpifjes.¹⁰⁰ Rreth 50 gazetarë dhe mediume kanë marrë ndihmë juridike nëpërmjet këtij mekanizmi.

⁹⁸ Intervistë me Vasko Maglleshov në redaksinë Prizma/BIRN, e realizuar me e-postë, 2.04.2021

⁹⁹ SPGM (2017) “SPGM: Të drejtat autoriale duhet të respektohen”, e publikuar në: Akademik.mk. 14.12.2017, <https://akademik.mk/ssnm-avtorskite-prava-mora-da-se-pochituvaaat/?fbclid=IwAR0c5ESYV0R9-mOJUgOhBZPM5pnFSOFuQ43Qb-02mf8eu4Ul3vsfj-Aqs7g>

¹⁰⁰ Qendra për Zhvillim të Mediave, “Ndihma juridike pa pagesë për gazetarët dhe për mediumet” Shkup: QZHM, <http://mdc.org.mk/besplatna-pravna-pomos>

Nga shembujt pozitiv të bashkëpunimit me institucionet, raportet theksojnë se MPB, megjithatë kanë bërë përpjekje që të zbatohet hetim i shpejtë për pjesën më të madhe të rasteve, ndërsa ka krijuar regjistrin e brendshëm për sulme mbi gazetarët.¹⁰¹ “Është e dukshme aktivitetet më i madh i MPB-së në gjetjen e sulmuesve të gazetarëve për dallim nga më herët”, vlerësojnë profesionistët mediatik.¹⁰²

Në drejtim të ngritjes së vetëdijes për nevojën e aksionit të shpejtë dhe efikas të institucioneve për mbrojtje të gazetarëve dhe profesionistëve mediatik, SHGM realizon trajnime me përfaqësues të Prokurorisë Publike, MPB-së dhe gjykatave, gjë që ishte theksuar edhe në Raportin për avancimin e shtetit të cilin e përgatit Bashkimi Evropian. Në fund të vitit 2019, SHGM e nënshkroi edhe protokollin për bashkëpunim me MPB-në, i cili jep udhëzime edhe për policinë edhe për gazetarët me qëllim siguri më të madhe gjatë realizimit të detyrave të tyre.¹⁰³ Në bashkëpunim me Akademinë për trajnime të gjykatësve dhe prokurorëve publik në 2020/21 janë realizuar trajnime me gazetarë dhe përfaqësues të gjyqësorit. Përndryshe, temat të cilat kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes janë pjesë e programeve të rregullta për trajnim që zbatohen në Akademinë, e dedikuar për gjykatës dhe prokurorë.

Nga viti 2018 deri në vitin 2021 janë formuar më tepër grupe punë në kuadër të ministrive të ndryshme të cilat punojnë në ndryshime të rregullativës ekzistuese me qëllim harmonizimin e saj me legjislativin evropiane. Në këto grupe punuese marrin pjesë përfaqësues nga të gjitha palët te përfshira, përfshirë këtu edhe të gazetarëve dhe organizatat mediatike të cilat i shqyrtojnë Kodin Penal dhe Kodin Zgjedhor si dhe Ligjin për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje. Përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe SHGM-së e theksojnë përparësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë, që paraqet shembull pozitiv në drejtim të avancimit të rregullativës mbi bazë të përvojës të cilën organizatat qytetare e kanë nga monitorimi dhe analiza e situatës në praktikë. Edhe mbrojtja e të drejtës autoriale,

¹⁰¹ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3diD7Vx>.

¹⁰² Intervistë me Vasko Magleshev në redaksinë Prizma/BIRN, e realizuar me e-postë, 2.04.2021

¹⁰³ SHGM (2019) “Protokoll për bashkëpunim mes SHGM-së dhe MPB-së”, i publikuar më dhjetor 2019 <https://znm.org.mk/potpishan-memorandum-so-mvr-za-bezbedn/>

ekspert e shohin si “sfidë ndërsektoriale i cili i bashkon organizatat e gazetarëve, gazetarët, fotoreporterët, avokatët, gjykatësit dhe pushtetin ekzekutiv.”¹⁰⁴

Në lidhje me praktikën gjyqësore, mund të theksohen aktvendimet në rastet gjyqësore në të cilat njëra palë është gazetarë, kur gjykatësit thirren në aktvendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo flet për avancim në praktikën gjyqësore për tema të cilat kanë të bëjnë me sferën mediatike. Përndryshe nga të gjitha gjykatat duhet të theksohet Gjykata themelore civile si i vetmi i cili udhëheq një regjistër joformal për veprat si shpifja dhe ofendimi.¹⁰⁵

10. PËRFUNDIM

Qeveria duhet të mundësojë kushte dhe rrethana në të cilat gazetarët dhe punonjësit mediatik të sigurt dhe papengësë do të mund t’i zbatojnë të drejtat dhe liritë me qëllim qytetarëve tu sigurojnë qasje deri tek informacionet kualitative të plota dhe profesionale. Kushti paraprak është ekzistimi i rregullativës ligjore funksionale e cila do të mundësojë garanca adekuate për realizim profesional të obligimeve të punonjësve mediatik në praktikën, e përputhur me standardet evropiane.

Në lidhje me sigurinë e gazetarëve dhe profesionistëve mediatik ishte analizuar Kodi Penal në të cilin ishin iniciuar ndryshim që duhet të kontribuojnë në avancim sistematik të sigurisë dhe ndalimin e politikës të mosndëshkimit për personat që kryejnë vepra ndaj tyre. Përpjekjet e komunitetit gazetares rezultuan me Propozim për ndryshime dhe plotësim të Kodit Penal të cilat pritet që të miratohen gjatë vitit 2021, sipas të cilave PTHP do të mund të veprojë me detyrë zyrtare për vepra ku janë të kërcënuar siguria dhe të drejtat e gazetarëve ose profesionistëve mediatik, ndërsa do të vendoset edhe formë e kualifikuar për disa vepra, përfshirë edhe vrasjen, për të cilën dënimit janë më të mëdha. Një nga kërkesat e shoqatave të gazetarëve e cila mbeti e paadresuar me propozim-ndryshimet ka të bëjë me vendosjen e

¹⁰⁴ Pashoski, D. (2021) “Si Ligji për të drejta autoriale ndikon mbi punën e punonjësve mediatik”, Shkup: SHGM, https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/Analiza_avtorski-prava_fin.pdf. Fq.15

¹⁰⁵ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3diD7Vx>. fq.25

veprave të reja penale për gjuhë të urrejtjes, megjithatë Prokuroria dhe Ministria e Drejtësisë vlerësojnë se kjo është çështje shumë komplekse për të cilën është i nevojshëm veprim i kujdesshëm.

Për prokurorinë dhe MPB-në, që këtu edhe për gazetarët të cilët cak i sulmeve dhe kërcënimeve, problem paraqesin veprat penale të bëra nëpërmjet mediave online, kur mediumi nuk ka impresum dhe Prokuroria duhet të kërkojë informacione nga njësi për luftë kundër krimit kompjuterik dhe forenzikë digjitale në MPB, që shumë shpesh është e pasuksesshme. Veprimi i këtyre institucioneve në këto raste është e pakoordinuar, e ngadaltë dhe shpesh pa rezultat.

Sa i përket paralajmërimeve për rikthimin e reklamimit shtetëror që ishte shfuqizuar në vitin 2017, komuniteti mediatik e cilëson këtë mundësi si kërcënim për pavarësinë e mediumeve dhe tregut mediatik në të cilin tani më ka të ardhura nga Buxheti. Fushata publike në mediat provat u treguan si praktikë jashtëzakonisht e dëmshme në të kaluarën, kur ishin shfrytëzuar si mekanizëm për blerjen e përkrahjes të mediumeve. Nga aspekti i prishjes së pavarësisë së mediumeve ishte analizuar edhe financimi i servisit publik TVM i cili ballafaqohet me pengesa institucionale duke e pasur parasysh faktin se nuk i realizojnë në tërësi pagesat e parashikuara ligjore. Kjo i vendos në një situatë jo të volitshme ekonomike të punësuarit në sektorin publik dhe e vendos në pikëpyetje mirëmbajtjen e saj, posaçërisht në situatë kur TVM i zgjeron ofertat programor. Me financimin jo të rregullt dhe jo adekuat të TVM-s, prishet koncepti i pavarësisë financiare të servisit publik që është një nga dy parakushtet për servise të pavarura publike.

Mundësia për reklamim të partive në mediumet gjatë fushatave zgjedhore me para publike paraqet zgjidhje problematike në Kodin Zgjedhor sepse mund të ndikojë mbi pavarësinë e politikës redaktuese edhe lirisë së mediave. Ekspertët apelojnë që të rishqyrtohet kjo mënyrë e financimit të partive gjatë fushatave parazgjedhore, edhe pse tek partitë ekziston një lloj konsensusi lidhur me këtë çështje. Mospërputhja në rregullativën ligjore në lidhje me definicionet dhe rregullat për reklamim politik është në disa ligje, që imponon debat për pajtueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e dispozitave në të gjithë rregulloren. Në mënyrë shtesë, mundësia internet-portalet të jenë pjesë e mediave nëpërmjet të cilave mund të realizohet reklamimi zgjedhor hap probleme shtesë, së pari, për shkak mosekzistimit të kriterëve cilat

internet portale mund të paraqiten në regjistrin e KSHZ-së, dhe më pas për shkak kapacitetet të Komisionit për verifikim të paraqitjeve.

Me ndryshimet e propozuara në Ligjin për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim do të ulen kostot për kompensim të dëmit dhe në mënyrë shtesë do të rregullohet përgjegjësia për shpifje, që është në pajtueshmëri me kërkesën e komunitetit gazetaresk. Pranimi i këtyre ndryshimeve do të thotë ulje shtesë të presionit të cilat përfaqësuesit e qendrave të pushtetit mund t'i bëjnë ndaj medimeve ose ndaj gazetarëve.

Duke e ditur se të drejtat autoriale janë një nga problemet më të theksuara në sferën mediatike për shkak shkëlqes së vazhdueshme posaçërisht në mediat online, ekspertët theksojnë se në Ligjin për të Drejta Autoriale dhe të Drejta Lidhur me të, së pari duhet të precizohen dispozitat për mbrojtje të punimeve gazetareske si vepra autoriale. Në lidhje me çështjen aktuale që ka të bëjë me vepra që bëhen në marrëdhënie pune, rekomandohet që të drejtat materiale t'i takojnë autorit, në vend punëdhënësit, siç është rasti tani. Posaçërisht është i parregulluar segmenti i të drejtave autoriale kolektive dhe menaxhimi me to, për të cilat analizat komparative tregojnë për shembuj funksional nga rajoni.

Ligji për media ishte shqyrtuar nga aspekti i internet portaleve, të cilët u imponuan si problem në vitet e fundit në tjera ligje, por edhe në praktik. Ata nuk janë të definuar në Ligjin për medime, por sipas ekspertëve, nuk duhet të bëhet dallim në mes mediave tradicionale dhe mediave online, kështu që ligjet që vlejnë për njërin duhet të vlejnë edhe për tjetrin. Ri-rregullimi i sferës së internetit është në kundërshtim me standardet evropiane, ndërsa me ligjet aktuale është vendosur korniza në të cilën mund të funksionojnë internet portalet. Komuniteti mediatik duhet t'i përkrahë mekanizmat vet-rregullues si mënyrë në të cilën mund të mirëmbahen dhe nxiten standardet profesionale tek internet-mediat.

Përpos garancive ligjore për siguri të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, është i nevojshëm edhe përkrahje institucionale dhe vullnet politik për zbatim të rregullativës. Në praktikën, disa segmente nga sistemi ende po dështojnë në azhurnimin dhe efikasitetin gjatë procedimit të rasteve në të cilat janë të përfshirë gazetarët, dhe për këtë shkak shkalla e mosndëshkimit për sulmet është ende shumë e

lartë. Vlerësimet e ekspertëve mediatik janë se “në rrethin të cilin e formojnë MPB, PTH dhe gjykatësit pothuajse cohe herë frenon të paktën njëra nga këto tre institucione.¹⁰⁶ Zakonisht më të kritikuar në aspekt të zbardhjes së rasteve të sulmeve mbi gazetarët janë MPB dhe Prokuroria Publike mes të cilave ekziston “moskoordinim i dukshëm dhe dobësi në komunikimin ndër-institucional”. Për këtë hetimet zgjasin më shumë, madje edhe kur bëhet fjalë për lëndë të cilat shumë lehtë mund të dëshmohen.

Prokuroria Publike e thekson nevojën për ndihmë sistematike në punën, siç janë mungesa e prokurorëve publik, bashkëpunëtorëve profesionale, procesverbalit, informaticistë, staf shtesë dhe pajisje të Qendrave të hulumtimit, si dhe rritje të buxhetit.¹⁰⁷

Gjykatat janë ende një nga zinxhiri i dobët në sistemin ngase u mungon edukim i vazhdueshëm dhe edukim shtesë për temat lidhur me lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes, edhe pse ka më tepër gjykatës të cilët janë të specializuar në fushat siç janë shpifja dhe ofendimet, ose të cilët thirren në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në kuadër të këtij vlerësimi janë aktvendimet gjyqësore me të cilat u refuzuan paditë e gazetarëve të cilët paditën për pengim të së drejtës për informim të qytetarëve në Kuvend më 27 prill 2017.¹⁰⁸

REKOMANDIMET

Për vendim-marrësit

1. Është e nevojshme Kuvendi t'i miratojë propozim ndryshimet dhe plotësimet të Kodit Penal me të cilat do t'i mundësohet Prokurorisë Publike të veprojë në bazë të detyrës zyrtaret gjatë sulmit ndaj gazetarëve dhe profesionistëve mediatik, si dhe ndryshimet të cilat parashikojnë vendosjen e veprave penale të kualifikuara, të cilat do të vlejnjë edhe për gazetarët edhe për profesionistët mediatik. Këto ndryshimet janë në pajtueshmëri me për përpjekjet e komunitetit

¹⁰⁶ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3a6NjOK>. fq 23-24

¹⁰⁷ PTH (2021) “Dorëzim i të dhënave në lidhje me pyetjet të parashtruara deri tek PTH nga ana e SHGM-së”, 05.04.2021

¹⁰⁸ Sekullovski, D dhe Sulejman, D.(2020) Maqedonia e Veriut-Treguesit e shkallës së lirisë së mediave dhe siguria e gazetarëve 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3ahjEIX> fq 28

gazetaresk për procedim të shpejt dhe efektiv të dhunës kundër gazetarëve dhe profesionistëve mediatik.

2. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria për Punë të Brendshme duhet të shqyrtojnë sugjerimet e shoqatave të gazetarëve për ndryshime në Kodin Penal dhe Ligjin për Procedurë Penale për Plotësim që do të kontribuonte në ndalimin e kryerësve potencial të kërcënimeve serioze dhe sulmeve të adresuara ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik në të ardhmen.
3. Neni 102 nga Ligji për ASHAM duhet të precizohet kështu që qartë do të kufizohen mundësitë mediumet të marrin mjete nga buxheti, në nivel nacional dhe lokal ose nga ndërmarrje publike, për reklamim ose për aktivitetet promovuese të institucioneve, nëpërmjet çfarëdolloj mekanizmi ose çfarëdolloj baze.
4. Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë duhet të mundësojë financim të TMV-s në mënyrë të rregullt, pa pengesë dhe të plotë në pajtim me Ligjin për ASHAM, me qëllim që të mundësohet funksionimi stabil, pavarësi më të madhe dhe zhvillim të mëtejshëm. Stabiliteti financiar është një nga kushtet themelore për servis publik të pavarur dhe të lirë.
5. Institucionet relevante, para se gjithash Ministria e Drejtësisë, duhet të hapin debat me qëllim që të rishqyrtohen dispozitat për reklamim të partive politike në mediat në Kodin Zgjedhor, posaçërisht në pjesën me të cilin mundësohet mbulim direkt i shpenzimeve nga Buxheti, duke e pasur parasysh mundësinë e krijimit të relacioneve politiko-klineteliste mes partive politike dhe mediumeve, që mundë të prish politikën e pavarur redaktuese dhe lirinë e mediave.
6. Institucionet relevante duhet të hapin debat gjithëpërfshirës për dispozitat në disa Ligje të cilat kanë të bëjnë me reklamimin politik dhe shtetëror (Kodi Zgjedhor, Ligji për Referendum, Ligji për ASHAM) me qëllim rishqyrtimin e funksionalitetit dhe efikasitetit si dhe ndërlidhje dhe harmonizimin e tyre.
7. Është e nevojshme Kuvendi t'i miratojë propozim-ndryshimet për plotësimin e Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe ofendim me të cilat ri-precizohet përgjegjësia për shpifje dhe parashikohet ulja e shumës për kompensim të dëmit, që janë në përputhje me

përpjekjet e komunitetit gazetaresk. Kjo do të kontribuonte në trajtimin e aktvendimit si satisfaksion simbolik për paditësit, gjegjësisht paralajmërim simbolik për gazetarët, redaktorët dhe pronarët e mediave.

8. Rregullativa Ligjore e cila vlen edhe për mediat tradicionale vlen edhe për internet mediat, por nevojitet konsistencë më madhe, pajtueshmëri dhe zbatim i qëndrueshëm i ligjeve në praktikën nga ana e institucioneve. Për çështjet të cilat kanë të bëjnë me tema të ndjeshme (shembull gjuha e urrejtjes, diskriminimi, të drejtat autoriale, shpifja dhe ofendimi, të drejtat e fëmijëve) është e nevojshme të mundësohet zbatimi i dispozitave të Ligjeve relevante që do të vlejné si për mediat tradicionale, ashtu edhe për mediat online,
9. Ministria e Kulturës së bashku me shoqatat e mediave, shoqatat sindikale dhe relevante nga fusha dhe palët tjera të tanguara, duhet të hap debat publik për të ri-precizuar më tepër dispozita nga Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me të, që kanë të bëjnë me: identifikimin dhe definimin e punimeve gazetareske autoriale, të drejtat autoriale të krijuara gjatë marrëdhëniet të punës, të drejtat kolektive dhe menaxhimin me të, zbritjen e shpenzimeve gjyqësore në procedurat gjyqësore për të drejtat autoriale dhe çështje tjera relevante.

Për institucionet

1. Janë të nevojshme trajnime të vazhdueshme për avancimin e bashkëpunimit mes gazetarëve, avokatëve, gjykatësve dhe prokurorëve për tema lidhur me lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes së gazetarëve dhe rasteve gjyqësore për sulme mbi gazetarët.
2. Në bashkëpunim me shoqatat të gazetarëve dhe të medimeve, është e nevojshme avancim i njohurive dhe profesionalizmit të gjykatësve për tema specifike lidhur me punën e medimeve dhe gazetarëve (shembull për tema autoriale ose shpifje dhe ofendim) nëpërmjet trajnimeve shtesë, posaçërisht duke e pasur parasysh praktikën e vogël gjyqësore në fusha të caktuara.
3. Në bashkëpunim me shoqatat e gazetarëve dhe të medimeve,

SHGM dhe Këshilli për Etik në Mediat në Maqedoni, është e nevojshme të organizohen trajnime për gjykatësit dhe prokurorët publik për tema lidhur me standardet etike dhe profesionale në gazetari, me çka do të mundësohet afrimi me thelbin e profesionit gazetaresk dhe do të mundësohet të njihen me konceptin e interesit publik në raportimin gazetaresk.

4. Është e nevojshme të përforcohen kapacitetet teknike dhe të kuadrit të Prokurorisë Publike në drejtim të rritjes së përshtatshmërisë gjatë zbatimit të procedurave, përfshirë edhe ata në të cilat ka gazetarë dhe profesionistë mediatik.
5. Duhet të avancohet praktika, procedurat dhe koordinimi i ndërsjellë i Prokurorisë Publike dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për procedimin e sulmeve të gazetarëve dhe punëtorëve mediatik nëpërmjet mediave online dhe rrjeteve sociale, me qëllim gjetjen e shpejtë dhe efikase të autorëve dhe hapjen e procedurave kundër tyre.

Për shoqatat civile

1. Komuniteti i mediave duhet t'i përkrahë mekanizmat vetërregulluese të cilat mund t'i nxisin dhe avancojnë respektimin e standardeve profesionale dhe etike në online mediat, me çka në më shumë situata do të ulet nevoja për reagimin e institucioneve.
2. Komuniteti i gazetarëve dhe i mediave duhet të realizojë fushata për ngritjen e vetëdijes në shoqërinë mediatike, por edhe në opinionin e gjerë për rëndësinë e çështjes lidhur me sigurinë e gazetarëve dhe profesionistëve mediatik dhe lirinë e mediave.
3. Janë të nevojshme trajnime për gazetarët dhe profesionistët mediatik për çështjet specifike lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre para institucioneve.
4. Përforcimin e bashkëpunimit me institucionet me qëllim krijimin e mekanizmave për mbrojtje efektive të gazetarëve dhe profesionistëve mediatik.

Literatura e përdorur:

1. ASHMAA (2020) “Analiza na pazarot na audiovizuelni mediumski uslugi za 2019 godina”, Shkup: ASHMAA, <https://bit.ly/3aaYbev>.
2. Apostolov, V dhe Trpkovski, G. (2020) “Portalite i paritë pred izbori: Guzhva pred gol”, publikuar në Prizma/BIRN, 07.03.2020, <https://prizma.mk/portalite-i-parite-za-izbori-guzhva-pred-gol/>
3. Bogdanov, K., Breshkovski, I. Dhe Sekulovski, D. (2020) “Podobruvanje na bezbednosta na novinarite preku izmena na Krivichniot zakonik”, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3slkLHA>
4. Breshkovski, I., dhe Markovski, I. (2018) “Vlijaniето na Zakonot za avtorsko pravo i srodni prava vrz rabotata na novinarite, fotoreporterite i mediumskite rabotnici – praktiki i preporaki”, Shkup: KAS dhe SHGM, www.znm.org.mk
5. SHGM (2018) “Analiza: Presudi za kleveti i navredi na sudski predmeti so novinari”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/analiza-presudi-za-kleveti-i-navredi-n/>
6. Georgievski, D. (2020) “Navredata i klevetata kako del od mediumskite reformi”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Navredata-i-klevetata-1.pdf>.
7. SHGM (2020) “Najaveni zakonski izmeni za pogolema bezbednost na novinarite”, Shkup: 2020, <https://bit.ly/3timsqE>.
8. SHGM (2020) “Principielni baranja na ZNM za izmena i dopolna na Zakonot za gragjanska odgovornost od kleveta i navreda (ZGONK) na ZNM”, Shkup: 2020.
9. SHGM (2020) “Rabotenjeto na profesionalnite mediumi na udar na plagijatorstvoto”, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3wTQVgT>
10. SHGM (2021) “Ushte edna sramna presuda za novinarite za nastanite od 27 april”, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/2QgWaqD>
11. SHGM, SPGPM, IMM dhe SPGPM (2021) “Javnite kampanji vo mediumite treba da se besplatni”, Skopje, <https://bit.ly/2OPMJ0y>.
12. SHGM (2019) “Protokol za sorabotka pomegu ZNM i MVR”, i publikuar në dhjetor 2019, <https://znm.org.mk/potpishan-memorandum-so-mvr-za-bezbedn/>
13. Ivanov, Z. Dhe Markovski, I. (2019) “Hronika za (ne)bezbednosta na novinarite”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/>

- uploads/2020/04/web-MK-hronika-za-ne-bezbednosta-nanovinarite.pdf.
14. Jovanovska, M., dhe Cvetkovska, S. (2020) “Drzhavni pari za izborni informaciski vojni”, publikuar në IRL.mk, 23.07.2020, <https://irl.mk/drzhavni-pari-za-izborni-informatsiski-voni/>.
 15. Mrgja, D., Murtezi, E. Dhe Bellovska, H. (2019) “Napadite vrz novinarite i mediumskite rabotnici na 27 april 2017 godina”, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Napadi-27-april.pdf>
 16. Mitevska, M., “Da ne se sluchi povtorno drzhaven potkup na mediumite”, Radio Slobodna Evropa, <https://bit.ly/2OKafvJ>; <https://irl.mk/kako-zaev-na-golema-vrata-protnuva-gruevistichki-retsept-za-mediumski-potkup/>
 17. Nebiu, B., Selmani, N., Sekullovski, D. Dhe Naumovski, N. (2018) Severna Makedonija – Pokazатели za stepenot na sloboda na mediumite i bezbednosta na novinarite 2017, Shkup: SHGM, <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Pokazатели-na-stepen-na-sloboda.pdf>.
 18. Nikodinoska, V. (2020) “Politichka i ekonomska osnova na mediumskite i na komunikaciskite modeli shto shirat dezinformacii i govor na omraza”, Shkup: IMM, <https://mim.org.mk/attachments/article/1230/Mediumski%20i%20komunikaciski%20modeli%20koi%20shirat%20dezinformacii%20i%20govor%20na%20omraza.pdf>
 19. OSBE/ODIHR, “Specijalna misija za procenka na izbori Republika Severna Makedonija – Predvreteni parlamentarni izbori”, 15 korrik 2020, <https://www.osce.org/files/f/documents/8/2/457426.pdf>
 20. PTHP (2020) “Informacija za oformeni predmeti vo koi kako osh teten subjekt ili zhrtva se javuva novinar”, 6.10.2020.
 21. Pashoski, D. (2021) “Kako Zakonot za avtorsko pravo vlijae vrz rabotata na mediumskite rabotnici”, Shkup: SHGM, https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/01/Analiza_avtorski-prava_fin.pdf.
 22. Reporterë pa Kufij (2020) Indeks na slobodata na mediumite, <https://rsf.org/en/north-macedonia>

23. Sekullovski, D. Dhe Sulejman, D. (2020) Severna Makedonija – Pokazатели za stepenot na sloboda na mediumite i za bezbednosta na novinarite 2019, Shkup: SHGM, <https://bit.ly/3a6NjOK>.
24. SPGPM (2017) “SSNM: Avtorskite prava mora da se pochtuvaat”, publikuar në: Akademik.mk, 14.12.2017, <https://akademik.mk/ssnm-avtorskite-prava-mora-da-se-pochituvaaat/?fbclid=IwAR0c5E5YV0R9-m0JUgOhBZPM5pnFSOFuQ43Qb-02mf8eu4U13vsfj-Aqs7g>
25. Trpevska, S. Dhe Selmani, N. (2018) “Komparativna analiza na politichkoto oglasuvanje vo mediumite”, Shkup: KAS dhe SHGM, <https://resis.mk/attach/komparativna-politicko-oglasuvanje.pdf>.
<https://resis.mk/attach/komparativna-politicko-oglasuvanje.pdf>.
26. Qendra për Zhvillimin e Mediave, “Besplatna pravna pomosh za novinari i za mediumi”, Shkup: QZHM, <http://mdc.org.mk/besplatna-pravna-pomos>
27. 360 stepeni (2020) “Emil Jakimovski dobi zatvor od 20 meseci i zadolzhitelno lekuvanje vo Bardovci”, 16.03.2020, <https://360stepeni.mk/emil-jakimovski-dobi-zatvor-od-20-mesetsi-i-zadolzhitelno-lekuvane-vo-bardovtsi/>.
28. CMEM (2017) “Self-regulation or Regulation of Internet Media in Macedonia”, Skopje: CMEM, <https://semm.mk/attachments/SELF-REGULATION-OR-REGULATION-OF-INTERNET-MEDIA.pdf>.
29. IREX (2019) MSI 2019, <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-north-macedonia.pdf>.
30. European Commission (2020) “North Macedonia 2020 Report “, Brussels: EC, 6.10.2020, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf
31. US Department of State (2020) “2020 Country Report on Human Rights Practices: North Macedonia”, 30.03.2021, <https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/>
32. Saracini, P., (ed.) et all. (2015) “Macedonia in the digital age – between the rights and responsibilities in the Internet communication”, Skopje: MIM, http://mim.org.mk/attachments/article/853/MIM_Analiza_mk.pdf.

Ligje:

1. Ligji për të drejtën e autorëve dhe të drejtat e përafërta, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 115/10, 140/10, 51/11, 147/13, 154/15 и 27/16
2. Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, <https://avmu.mk/%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD-%D0%B7%D0%B0-%D0%B0%D1%83%D0%B4%D0%B8%D0%BE-%D0%B8-%D0%B0%D1%83%D0%B4%D0%B8%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D0%B7%D1%83%D0%B5%D0%BB%D0%BD%D0%B8-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC/>
3. Ligji për media, https://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Zakon_za_mediumi_mkd.pdf
4. Kodi Zgjedhor, <https://avmu.mk/%D0%B8%D0%B7%D0%B1%D0%BE%D1%80%D0%B5%D0%BD-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D0%BA/>
5. Ministria për Drejtësi (2020) Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=6143
6. Propozim-ligji për ndryshime të Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=58871

Intervista:

1. Intervistë me Vasko Magleshev, gazetar në redaksinë e Prizma/BIRN, e zbatuar përmes postës elektronike, 2.04.2021.
2. Intervistë me Hristina Bellovska, gazetare në IRL, e zbatuar përmes postës elektronike, 2.04.2021.
3. Intervistë me Nikolla Prokopenko, këshilltar shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë, e zbatuar më 29.03.2021, online.
4. Prokuroria Themelore Publike dërgoi të dhëna dhe informata në lidhje me pyetjet e parashtruara nga ana e SHGM-së, 05.04.2021.
5. Intervistë me Snezhana Trpevska, kryetare e Institutit Resis, e zbatuar më 23.03.2021 online.
6. Intervistë me Dejan Georgievski, kryetar i Qendrës për Zhvillim të Mediave, e zbatuar më 24.03.2021 online.



Zдруženje na novinarite na Makedonija

<https://znm.org.mk/>



<https://sindikatmedija.me/>



<http://www.nuns.rs/ebo>



<https://bhnovinari.ba/>